



Botues: Rolf Gollob dhe Peter Krapf  
Përkthyes: "UEGEN"  
Përgjegjës për botimin shqip: Astrit Dautaj

# Mësimdhënia e demokracisë

Përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetari demokratike  
dhe edukimin e të drejtave të njeriut

## **Mësimdhënia e demokracisë**

Një përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetari demokratike dhe e të drejtave të njeriut

Botues/autorë:

Rolf Gollob

Peter Krapf

Ilustrimet:

Peti Wiskemann

*Përktheu: Aida Serjanaj*

*Përgjegjës për botimin shqip: Astrit Dautaj*

Vëllimi VI

I

Vëllimeve EQD/EDNJ I-VI

Edukimi për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut në praktikën e shkollës

Njësi mësimore, koncepte, metoda, modele

Botim i Këshillit të Evropës

Vlerësimet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e autorëve dhe, jo doemos, pasqyrojnë politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, të riprodhohet ose të përcillet në çdo formë ose me çdo mjet, elektronik (CD-Rom, Internet etj.) ose mekanik, duke përfshirë shumëfishimin, regjistrimin ose çdo ruajtje e informacionit ose rikthim sistemi, pa lejen paraprake me shkrim nga Sektori i Botimeve të Informimit Publik dhe Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex ose [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)).

Bashkërendimi për prodhimin, skicimin dhe redaktimin e këtij vëllimi është bërë nga IPE (Projektet Ndërkombëtare në Arsim, [www.phzh.ch/ipe](http://www.phzh.ch/ipe)) të Universitetit të Formimit të Mësuesve i Zyrihut (Pädagogische Hochschule Zürich - PHZH).

Ky botim është bashkë financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim (SDC)

Korrektimi nga Departamenti i Dokumenteve dhe i Prodhimit të Botimeve (DPPD),  
Këshilli i Evropës

Ilustrimet: Peti Wiskemann

Kapaku: Peti Wiskemann

Faqosja: Mourreau

Botim i Këshillit të Evropës

F-67075 Strasbourg Cedex

<http://book.coe.int>

© Këshilli i Evropës, Dhjetor 2008

Shtypur në Belgjikë

Bashkautorët dhe bashkëpunëtorët:

Emir Axhoviç – Bosnjë-Hercegovinë  
Saliha Agiç – Bosnjë-Hercegovinë  
Suad Aliç – Bosnjë-Hercegovinë  
Irena Batiç – Bosnjë-Hercegovinë  
Emina Dediç – Bosnjë-Hercegovinë  
Elisabeth Hösli – Zvicër  
Mirjana Knezheviç – Bosnjë-Hercegovinë  
Dunja Laziç – Bosnjë-Hercegovinë  
Franziska Gerster – Zvicër  
Helen Lehmann – Zvicër  
Sabrina Marruncheddu – Zvicër  
Michel Herode – Belgjikë  
Reto Moritzi – Zvicër  
Monique Nobs – Zvicër  
Michel Rapp – Gjermani  
Valerie Shaw – Britania e Madhe  
Vedrana Spajiç-Vrkash – Kroaci  
Keith Sprague – Zvicër  
Zoran Stojanoviç – Bosnjë-Hercegovinë  
Zdravko Sunkiç – Bosnjë-Hercegovinë  
Valerie Travis – Britania e Madhe  
Kemal Velagiç – Bosnjë-Hercegovinë  
Wiltrud Weidinger – Zvicër

Përmbajtja	
Hyrje .....	9
<b>Kapitulli 1- Krijimi i atmosferës në klasë</b>	
Hyrje .....	11
1.1. Kartat që përputhen .....	12
1.2. Të drejtat, përgjegjësitë dhe rregullat në klasë .....	13
1.3. Identiteti i emblemave .....	15
1.4. Një tufë me lule .....	17
1.5. Shkopinj të kinezë .....	18
<b>Kapitulli 2 - Qartësimi i vlerave</b>	
Hyrje .....	19
2.1. Loja me trap .....	20
2.2. Sistemi i vlerave .....	21
2.3. Filozofia e jetës .....	23
<b>Kapitulli 3 - Njohja me të drejtat e njeriut</b>	
Hyrje .....	25
3.1. Afishja e të drejtave të njeriut .....	27
3.2. Spango .....	29
3.3. Pema e të drejtave të njeriut .....	30
3.4. Udhëtimi me balonë .....	31
3.5. Dëshirat dhe nevojat .....	33
3.6. Kutia e thesarit .....	34
<b>Kapitulli 4 - Të kuptojmë të tjerët</b>	
Hyrje .....	35
4.1. Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë .....	36
4.2. Ndryshimet .....	37
4.3. Të vërteta dhe të rreme .....	38
4.4. Mbresat e para .....	39
4.5. Të gjithë ne kemi paragjykime .....	40
4.6. Të gjithë jemi të barabartë, por disa ca më shumë .....	42
4.7. Turistët .....	43

4.8. Globingo: «Qenia njerëzore është pjesë e gjithë botës».....	45
<b>Kapitulli 5 – Funksionimi i drejtësisë</b>	
Hyrje .....	47
5.1. Kjo është e padrejtë .....	48
5.2. Përrjashtimi .....	49
5.3. Të formojmë figurën .....	50
5.4. Roli i ligjit .....	51
5.5. Këndvështrimet për drejtësinë .....	53
<b>Kapitulli 6 – Të kuptuarit e filozofisë politike</b>	
Hyrje .....	55
6.1. Konceptet themelore të mendimit politik .....	56
6.2. Qëndrimet ndaj pushtetit .....	57
6.3. Sikur të isha magjistar .....	59
<b>Kapitulli 7 – Pjesëmarrja në politikë</b>	
Hyrje .....	61
7.1. Muri i heshtjes .....	62
7.2. Mendimet e mia për diktaturën .....	63
7.3. Pyetëtori për qëndrimet ndaj ndryshimit .....	64
7.4. Projekti i planifikimit .....	67
7.5. Ne dhe bota .....	69
7.6. A duhet të marrim pjesë në politikë? .....	71
7.7. Si ndikon qeveria në jetën tuaj? .....	73
7.8. Mënyrat e pjesëmarrjes në demokraci .....	74
7.9. Cikli politik .....	75
<b>Kapitulli 8 – Menaxhimi i konfliktit</b>	
Hyrje .....	79
8.1. Zgjidhje të leverdishme për të gjitha palët .....	80
8.2. Një qasje e strukturuar për zgjidhjen e konflikteve .....	81
8.3. Konfliktet në familje dhe me bashkëmoshatarët .....	83
8.4. Ide për konfliktin dhe paqen .....	84
8.5. Shtatoret .....	85
8.6. Ndëshkimi kundrejt zgjidhjeve pozitive të konflikteve .....	86
8.7. Pakicat .....	88

8.8. Pamje të luftës dhe të paqes. ....	90
---	----

### **Ilustrimet**

Hyrje .....	91
1. Krijimi i atmosferës në klasë .....	92
2. Qartësimi i vlerave .....	93
3. Njohja me të drejtat e njeriut .....	94
4. Njohja e të tjerëve .....	95
5. Funkcionimi i drejtësisë .....	96
6. Të kuptuarit e filozofisë politike.....	97
7. Pjesëmarrja në politikë .....	98
8. Menaxhimi i konfliktit .....	99





# HYRJE

## 1. Çfarë ju mundëson ky libër

Ky libër përmban një përmbledhje me 47 ushtrime dhe modele për Edukimin për Qytetari Demokratike (EQD) dhe Edukimin e të Drejtave të Njeriut (EDNJ) në shkolla si dhe në mjedise jo formale të arsimit. Këto modele të mësimdhënies sigurojnë kuadrin e plotë të aktivizimit të nxënësit dhe japin shembuj, krijojnë mundësinë rreth të kuptuarit të parimeve të përgjithshme të demokracisë dhe të drejtave të njeriut (qasja induktive, duke mësuar me anë të shembullit). Përdoruesit do të zbulojnë se këto modele të mësimdhënies kërkojnë fare pak burime financiare (parimi i buxhetit të ulët).

Në një mësim ose kapitull, mundësisht me jo më shumë se me katër mësim, këto modele, zakonisht trehapëshe, duhet të nguliten mirë brenda një konteksti.

1. Mësimi ose kapitulli fillon me një hyrje për të sqaruar temën e mësim, qëllimin dhe objektivat e tij. Nxënësve u ngjallet interesi për këtë temë.
2. Nxënësit marrin udhëzime se si t'i kryejnë ushtrimet dhe materialet e nevojshme. Pasta, përfshihen në veprimtarinë e tyre.
3. Kjo është një fazë reflektimi, diskutimi dhe udhëzimesh të kujdesshëm. Metodatat e zakonshme janë kundërveprimet e nxënësve, diskutimi në klasë, të menduarit kritik dhe udhëzime nga mësuesi për të realizuar konceptin kyç që qëndron në themel të modelit. Pa këtë fazë të tretë, nxënësve do t'u krijohet përshtypja se thjesht janë duke zbatuar rregullat për hir të saj.

Fazat 1 dhe 3 nuk janë të përfshira në paraqitjen e modeleve (faza 2). Hyrjet e kapitujve japin një përmbledhje të konceptit kyç ose çështjen që është në qendër të ushtrimeve në atë pjesë; këtu mund të gjendet ndihma për fazën 3. Ky libër synon mësues me përvojë dhe ata mësues që janë të gatshëm të kalojnë ca kohë në përgatitjen me kujdes të mësim. Përgatitja, kryesisht, është detyrë e të menduarit me kujdes, duke u përqendruar në fazën 3. Kjo do të thotë se mësuesi duhet të parashtrijë disa pyetje: Cili do të jetë reagimi i nxënësve të mi? Çfarë ndjenjash do të zgjojë ky ushtrim? Cili është koncepti kyç që nxënësit e mi duhet të kuptojnë? Si ta paraqit atë? Si mund të zbatohet më pas?

Pyetjet që zgjedh mësuesi dhe përgjigjet që do të japin ata ndryshojnë, në varësi të grupit të veçantë të nxënësve, të moshës së tyre dhe mjedisit kulturor. Këtu, kemi përshkruar shembuj të ndryshëm se si mund të zbatohen disa nga modelet që përfshihen në këtë libër në vëllimet shoqëruese të këtij botimi EQ/EDNJ.

Shumë ushtrime janë të përshtatshme për grup-mosha të ndryshme, ndërsa niveli i reflektimit mund të ndryshojë. Disa modele, megjithatë, janë më të ndërlikuara dhe më abstrakte se të tjerat dhe, për këtë arsye, janë më të përshtatshme për nxënës më të përparuar.

## 2. Qasje të përbashkëta evropiane ndaj EQD/EDNJ

Përdoruesit do të zbulojnë se modelet ndjekin metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe të mësuarit. Disa prej tyre përqendrohen më tepër në krijimin e një përvoje të mirëfilltë (p.sh. «Një tufë me lule» ose «Lojë me bashkim pjesësh figure»), të tjerët theksojnë veprimtari të nxënësve në një mjedis të lojës me role (p.sh. «Turistët»). Ka një kategori të tretë materialesh që përqendrohen në tema të veçanta, të cilat mbështeten më shumë në informacione ose burime ekzistuese (p.sh. «Konceptet themelore të mendimit politik»). Së fundi, ka skica për plan pune që çon në përfundim produktesh (p.sh. «Afishja e të drejtave të njeriut»).

Shumëllojshmëria e gjerë e qasjeve pasqyron faktin se autorë nga të gjitha viset e Evropës kanë dhënë ndihmesën e tyre për këtë libër. Ata kanë shfrytëzuar burime, tradita mësimdhënies dhe të mësuarit të ndryshëm, si dhe kanë përzgjedhur modele që i njohin nga përvoja e vlefshme dhe të provuarit në klasë.

Megjithatë, ka një kuptim të përbashkët për EQD/EDNJ, që përshkon çdo pjesë të këtij libri: në EQD/EDNJ, metoda mbart mesazhin. Mësimdhënia *për* demokracinë dhe të drejtat e njeriut duhet të pasqyrohet duke dhënë mësim në frymën e këtyre parimeve, domethënë, t'i mësosh të tjerët përmes demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Prandaj, këto modele ndjekin parimin e të mësuarit me bazë detyre dhe nga përvoja vetjake. Ky kuptim i përbashkët i EQD/EDNJ me të vërtetë mund të quhet Qasje evropiane.

Varianti origjinal i këtij libri u prodhua për të mbështetur seminarat përgatitore për mësuesit EQD/EDNJ në Bosnjë dhe Hercegovinë pas luftës (1992–1995). Këshilli i Evropës ka organizuar seminare për mësuesit, që nga viti 1996 dhe këto veprimtari vazhduan deri në 2006-n. Qëllimi i këtyre seminareve ishte që të mbështeste ecurinë e arritjes së paqes mbas luftës. EQD/EDNJ duhet ta nxitë brezin e ri të zhvillojë një kulturë të tillë politike që mbështet një shoqëri moderne pluraliste dhe tolerante, me institucione demokratike të forta.

Dy vitet e para, autorët e këtij libri u bashkuan për të parapërgatitur mësuesit në mbarë Bosnjën dhe Hercegovinën në seminare verore që zgjatnin deri në dy javë. Konstatuam se mësuesit ishin gjithnjë mjaft të interesuar dhe të gatshëm për të rritur më tej edhe sfidën për të shkolluar nxënësit e tyre për demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Sidoqoftë, ata urgjentisht kërkonin materiale për t'u udhëzuar e mbështetur në punën e tyre. Brenda një viti, u arrit botimi i parë i këtij libri. Shpejt u bë i njohur si «Dosja Blu», për shkak të lidhjes së saj me Këshillin e Evropës, dhe u përdor gjerësisht, jo vetëm nga mësuesit në Bosnjë dhe Hercegovinë, por edhe në vende të tjera, përfshirë edhe Federatën Ruse, Moldavinë, Kroacinë, Serbinë dhe Malin e Zi. Reagimet e këtyre përdoruesve ndihmuan në nxjerrjen e një botimi të përmirësuar më 2000-n. Zbuluam se shumë prej mësuesve kërkonin udhëzime dhe mbështetje për të mësuarit në bazë detyre dhe integrimin e tij dhe të mësuarit konceptual, të paraqitur në vija të përgjithshme nga modeli i mësipërm tri hapësh.

Ne arritëm t'u përgjigjeshim kërkesave duke zhvilluar modele të mësimdhënies që përshkruajnë hapat brenda një vargu prej katër mësimesh të hollësishme. Variantet e rishikuara të këtyre modeleve gjenden në vëllimet III, IV dhe V të kësaj serie EQD/EDNJ.

Ky botim modelesh të mësimdhënies së EQD/EDNJ nuk bën më fjalë për kontekstin e posaçëm të Bosnjës dhe Hercegovinës. Ato, si modele mësimore që paraqitin qasje të përbashkëta evropiane për EQD dhe EDNJ, mund të përdoren në të gjithë Evropën dhe, për këtë qëllim, edhe në vise të tjera të botës. Autorë të ndryshëm janë bashkuar, si të thuash, gati si në një kor, duke kënduar të njëjtën pjesë, por sigurisht me zërat e tyre të ndryshëm. Kjo u jep përdoruesve mundësinë për të zgjedhur dhe për të provuar qasjet dhe traditat e ndryshme brenda qasjes evropiane ndaj EQD/EDNJ.

## **Mirënjohje**

Duam të falënderojmë tërë autorët që kanë dhënë ndihmesën e tyre në këtë libër dhe që kanë dhuruar gjithë pasurinë e ideve dhe qasjeve të tyre. Gjithashtu, shprehim mirënjohjen tonë për mësuesit, këshilltarët e pedagogjisë, trajnerët dhe anëtarët e grupit të vlerësimit të portofolit në Bosnjë-Hercegovinë, që kanë eksperimentuar modele dhe na kanë dhënë komente të vlefshme. Falënderojmë znj. Olof Olafsdottir dhe znj. Sarah Keating-Chetwynd nga Këshilli i Evropës për durimin e tyre, inkurajimin dhe mbështetjen për përfundimin me sukses të këtij projekti. AZHB (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Bernë) ka dhënë një ndihmë të pakursyer që i mundësoi PNA (Projektet Ndërkombëtare në Arsim), institut i PHZH (Universiteti i Formimit të Mësuesve), për të vëzhguar projektin. Dhe, në fund, falënderimet tona të veçanta i shkojnë z. Emir Axhoviç, Këshilli i Evropës, Sarajevë, për mbështetjen e tij të palëkundur që ka dhënë në të gjithë ato seminare të parapërgatitjes së mësuesve në Gorazhde, Brçko, Sarajevë, Banja Luka e në vende të tjera, ku kemi paraqitur «Dosjen Blu» dhe kemi marrë vlerësimet që na bënë të mundur prodhimin e këtij varianti të ri të rishikuar.


Zyrih dhe Weingarten, korrik 2008

*Rolf Gollob*

*Peter Krapf*

## Kapitulli 1

### Krijimi i atmosferës në klasë



#### Hyrje

Figura tregon nxënës që punojnë në klasë. Në të majtë, një djalë dhe një vajzë po punojnë së bashku; në tryezë gjenden materialet e tyre, duke përfshirë edhe një glob. Ata duket se janë përfshirë në diskutim. Në sfond, një nxënës ose mbase një mësues po prezanton diçka. Vajza në të djathtë ka ngritur dorën dhe pret të përgjigjet. Çdonjëri në klasë është duke punuar pa u lodhur dhe, si duket, kjo u pëlqen. Atmosfera në klasë është vendimtare për punë dhe të mësuar të frytshëm.

Këto pesë ushtrime përqendrohen në krijimin ose kthimin në klasë të një atmosferë të tillë që i bën ata të ndihen rehat dhe të sigurt. Kjo kërkesë themelore mbështet efektshmërinë e mësimdhënies dhe të mësuarit, meqë përçarja fiton terren dhe konsumon kohë dhe energji.

EQD/EDNJ ka shumë anë të përbashkëta me mësimdhënien e mirë. Kjo nuk vlen vetëm për këto pesë modele, por për të gjitha ushtrimet në këtë libër.

Megjithëkëtë, këto modele, kryesisht nuk janë konceptuar si mjete për administrimin e klasës; ato përmbajnë një mesazh më të thellë e më kuptimplotë. Sot reforma arsimore është, në një masë të madhe, një çështje se si të shkojë përpara nga dhënia e një mase njohurish dhe kuptimesh të caktuara në dukje të përhershme drejt një koncepti më dinamik të të mësuarit që zgjat gjithë jetën, që kërkon më shumë zhvillimin e kompetencave, se sa grumbullimin e fakteve dhe shifrave. Nga ky këndvështrim, shkolla konceptohet si një mikro-shoqëri – një vend ku nxënësit ndeshen me përvojat dhe problemet që kanë mjaft gjëra të përbashkëta me jetën e të rriturve. Prandaj, nxënësit duhet të mësojnë se si t'i zgjidhin probleme të tilla në shkollë. Këto ushtrime i ndihmojnë ata të bëjnë këtë mikro-shoqërisë të funksionojë, nëpërmjet njohjes së njeri-tjetrit, duke u marrë vesh për rregullat brenda grupit, duke ndarë përvojën vetjake me të tjerët dhe duke vlerësuar veten, duke përcaktuar identitetin brenda grupit dhe duke bashkëpunuar me të tjerët. Këto detyra janë njësoj të rëndësishme dhe të përshtatshme si për nxënësit e rinj, ashtu edhe për ata më të mëdhenj, por në nivele të ndryshme reflektimi..

Së fundi, nga pikëpamja e EQD/EDNJ, këto ushtrime i japin një mesazh të qartë mësimdhënies *nëpërmjet* frymës së demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Çdo nxënës është një individ që ndihmon me diçka të veçantë nga vetja në bashkësinë e nxënësve dhe mësimdhënësve në klasë. Çdo nxënës duhet të trajtohet me interes dhe respekt. Çdo rregull duhet të zbatohet njësoj për të gjithë. Kjo do të thotë: «Ajo që unë pres nga të tjerët është e njëjtë me atë që ata presin prej meje.» Nxënësit duhet të bëhen të vetëdijshëm për këtë mesazh, kështu reflektimi dhe të menduarit kritik në klasë janë thelbësore.

## Ushtrimi 1.1. – Kartat që përputhen

<i>Objektivi mësimor:</i>	Ky ushtrim u mundëson nxënësve të lidhen me të tjerët në një mënyrë të parrezikshme.
<i>Shënim për përdorim:</i>	Mësuesit mund ta përdorin këtë ushtrim për të vlerësuar nevojat e mësimit dhe parashikimeve të grupit të nxënësve të tyre.
<i>Burimet:</i>	Një tog letrash pokeri që përftojnë çifte.

### *Procedura:*

1. Mësuesi shpërndan letrat e pokerit kuturu dhe nxënësve kërkoju të gjejnë gjysmën tjetër të tyre.
2. Nxënësit, pasi ta kenë gjetur njëri-tjetrin, kalojnë 5-10 minuta duke zbuluar ca të dhëna themelore për njëri-tjetrin:
  - emrin e tyre
  - familjen e tyre
  - vendbanimin e tyre
  - kafshën e tyre e parapëlqyer ose grupin pop, skuadrën e futbollit, ngjyrën etj.
3. Nxënësit bashkohen me njëri-tjetrin. Secili prej tyre ka mundësinë ta njohë shkurt shokun me pjesën tjetër të grupit.<sup>1</sup>
4. Nxënësit ulen nëpër karrige në trajtë rrethore. Mësuesi, për të pasur ndonjë reagim, i nxit nxënësit të komentojnë atë çfarë është e re për ta, ose ajo që u la mbresa në veçanti.

### *Zgjerim*

Kjo veprimtari mund të zhvillohet më tej, duke u kërkuar, për shembull, nxënësve të shkollës fillore, që parapëlqejnë ngjyrën e kuqe, të mbliidhen së bashku, për të formuar grupe të vogla diskutimi.

### *Variacion*

Nxënësit eksplorojnë mënyra të ndryshme të paraqitjes së informacionit të tyre, për shembull nëpërmjet shprehjes me mimikë, duke bërë «reklamuar» mikun e tyre me afishe ose duke shkruar një poezi.

### *Materialet*

Një grup kartash tek të cilat është shkruar dhe vizatuar një objekt që shokun e ka te një kartë tjetër. Kartat duhet të përmbajnë emërtimin dhe vizatime të cilat do t'u mundësojnë nxënësve të rinj dhe atyre që kanë vështirësi në të mësuarit që të marrin plotësisht pjesë në ushtrim.

trëndafil – gjemb	ditë – natë	thikë – pirun	këpucë – çorape
dritë – errësirë	kripë – piper	stilolaps – letër	tryezë – karrige
i nxehtë – i ftohtë	i fortë – i dobët	lart – poshtë	i lartë – i ulët
jashtë – brenda	i hapur – i mbyllur	i madh – i vogël	i shpejtë – i ngadalshëm
i pastër – i pistë	i ashpër – i lëmuar	ndaloj – shkoj	filloj – përfundoj
mirë – keq	po – jo	mik – armik	i shëndoshë – i hollë
dielli – hëna	vëlla – motër	djalë – vajzë	

<sup>1</sup> Kjo duhet të shpjegohet nga mësuesi kur jep ushtrimin në mënyrë që nxënësit të mund të zgjedhin ato çfarë duan të zbulojë për veten e tyre.

## Ushtrimi 1.2. – Të drejtat, përgjegjësitë dhe rregullat në klasë

Objektivat mësimore	Kjo veprimtari paraqet një qasje «hap pas hapi», për t'u përdorur me nxënësit, në mënyrë që të vendosin ato rregulla të pranuar në mënyrë demokratike për grupin e tyre në klasë. Nxënësit kuptojnë që ndihmesa e tyre është e rëndësishme dhe se ata kanë mundësi të ndikojnë në hartimin e rregullave. Ata zhvillojnë ndjenjën e «pronësisë» dhe përjetojnë pjesëmarrje aktive në mjedisin e bashkësisë së klasës si mikro-shoqëri. Nxënësit ndërgjegjësohen për lidhjet mes të drejtave, përgjegjësi dhe rregullave (të cilat nënkuptojnë ligjet në kontekstin e klasës).
Burimet	Fletë të mëdha letre të ndara në tri pjesë të barabarta.

### Procedura

1. Duke përdorur «lojë» grup-formuese (p.sh., duke shpërndarë karta që përputhen për të formuar grupet e zhonglerëve, violinistëve etj.) Klasa ndahet në tri, gjashtë ose nëntë grupe, në varësi të madhësisë së saj. Secili grup nuk duhet të ketë më shumë se pesë nxënës. Secili nga grupet është A, B ose C.
2. Çdo grup cakton një zëdhënës. Mësuesi kërkon nga grupet mendime të shkurtra: si e kanë zgjedhur zëdhënësin e tyre?
3. Çdo grup ka një fletë letre të ndarë në tri pjesë. Duke përdorur një të tretën e sipërme të letrës, nxënësit shënojnë ato që besojnë se janë të drejtat e çdo individi (duke përfshirë mësuesin) në klasën e tyre. Ata duhet të shënojnë çdo sugjerim dhe çdonjëri prej tyre duhet numëruar.
4. Nxënësit japin mendime e tyre, duke u bazuar në pyetjet vijuese: A mendoni se e keni kryer mirë detyrën? Çfarë ju ndihmoi të gjithëve në atë që bëtë? Çfarë ju pengoi?
5. Nxënësit ia kalojnë punën grupit tjetër (A tek B, B tek C, C tek A).
6. Duke u bazuar në pyetjet në vijim, secili grup merr parasysht listën e të drejtave të krijuara nga grupi paraardhës: Çfarë përgjegjësi kemi ne për të respektuar këto të drejta? Çfarë duhet të bëjmë? Si nuk është mirë të sillemi? Për shembull: «Çdokush ka të drejtë të dëgjojë dhe ta dëgjojë.» – «Kemi përgjegjësi për t'i dëgjuar të tjerët.»  
Nxënësit, duke përdorur të njëjtët numra, si ato që janë përdorur në pjesën që flet për të drejtat, hedhin me shkrim një përgjegjësi përkatëse (nëse u vjen në mendje një prej tyre) në të tretën e mesme të fletës.<sup>2</sup>
7. Ndërhyrja e mësuesit: Rregulla për hir të rregullave.
  - Vendosni disa rregulla që të shfaqen dukshëm në klasë.
  - Rregullat duhet të jenë të formuluar në mënyrë pozitive: “Bëni diçka”, në vend të “Mos bëni diçka”.
  - Rregullat duhet të jenë të veçanta dhe të përshkruajnë sjelljen e kërkuar; p.sh. e drejta për të dëgjuar; ne kemi *përgjegjësinë* për të dëgjuar; *rregulli*: heshtni kur të tjerët janë duke folur.
8. Nxënësit e kalojnë fletën e letrës përsëri. Grupet i mbajnë parasysht të gjitha të dhënat nga dy grupet e tjera dhe merren vesh mbi një maksimum prej pesë rregullash. Këto shkruhen me shkronja të theksuara në të tretën e poshtme të letrës. Ky grup rregullash shkëputet dhe mbërthehet në mur. Zëdhënësi i çdo grupi shpjegon rregullat e tyre gjithë klasës.  
Mësuesi udhëheq diskutimin. Nxënësit identifikojnë rregullat e tepërta dhe merren vesh për kopjen(t) që do të fshijnë. Disa grupe mund të mos jenë të gatshme të lejojnë fshirjen e kontributeve të tyre, ndërsa të tjerët po. Nxënësit duhet të përpiqen të arrijnë një vendim që të pranohet nga të gjithë. Për t'u pranuar puna e të gjithëve, kopjet mund të ruhen për shqyrtim të mëtejshëm.

<sup>2</sup> Nganjëherë nxënësit e kanë të vështirë për të gjetur një përgjegjësi për çdo të drejtë

9. Votimi i rregullave. Çdo nxënës ka katër “xhetona” për të «shpenzuar» në rregullat që besojnë se duhet të përfshihen në klasë. Votën mund ta hedhin duke i shpërndarë xhetonat si të duan; për shembull, mund të duan që të gjitha votat t’i hedhin vetëm për një rregull apo t’i shpërndajnë në mënyrë të barabartë. Katër rregullat me numrin më të madh të votave të hedhura bëhen rregullat për klasën e tyre. Ato mund të rivlerësohen, të nënshkruara nga çdo nxënës dhe të shfaqen në mënyrë të dukshme në klasë.
10. *Reflektim*. Çfarë ju ka ndihmuar/penguar? Si keni kontribuar në veprimtaritë e zhvilluara? A e keni vënë re dikë tjetër në klasë, i cili ka bërë gjërat që ju ndihmuan? Çfarë bënë ata? Për klasën, kjo është mundësia e parë që të zbatojë rregullat e saj dhe t’i mbështetë ato. Mësuesi mund t’i lavdërojë nxënësit që zbatojnë rregullat. Në të gjitha rastet që është e mundur mësuesi duhet t’i shpërfillë ata që nuk i zbatojnë rregullat, sepse kjo do t’i vinte ata në «qendër të vëmendjes» për arsye të këqija.

## Ushtrimi 1.3. Identiteti i emblemave

Objektivat mësimore	Rritja e vetëbesimit; individët nxiten të njohin dhe lavdërojnë së bashku anët e tyre pozitive. Grupet gjejnë pikësynimet e tyre të përbashkëta.
Shënim mbi përdorimin	Ky ushtrim i lejon nxënësit të përfshihen shumë shpejt me gjithë zemër. Kjo është ideale për një grup mësimor të ngritur rishtas ose në fillim të sesionit të parapërgatitjes.
Burimet	Afische me simbole për secilin grup nxënësish, stilolapsa apo lapsa me ngjyra, fotografi nga revista etj.

### Procedura

1. Duke përdorur një «lojë» grup-formuese (p.sh., duke shpërndarë karta që përputhen për të formuar grupe me zhonglerë, violinistë etj.) klasa ndahet në tri, gjashtë apo nëntë grupe në varësi të madhësisë së saj. Secili grup s' duhet të ketë më shumë se pesë nxënës. Çdo grup është ose A, B apo C.
2. Nxënësit punojnë në grupe me nga katër vetë. Çdo nxënësi i jepet një skicë e emblemës me simbole, e cila është e ndarë në katër pjesë dhe ka një listë poshtë saj. Pjesët mund të jenë të prera paraprakisht nga një kopje e dytë, kështu që mund të ngjiten në emblemën fletën kryesore pasi të ketë përfunduar.

### 3. Detyra:




#### Përgatitja individuale:

- mbani shënim, duke u përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:
  - Si e shihni veten?
  - Për çfarë keni nevojë?
  - Çfarë jeni në gjendje të bëni?
  - Për çfarë ju vjen keq kur mendoni për jetën tuaj?
- tërhiqni (ose zgjidhni) një simbol ose simbole që paraqitin shënimet tuaja (ngjyra, letër me ngjyrë, fotografi revistash etj.).

#### Puna në grup:

- Shpjegojuni simbolin ose simbolet tuaja anëtarëve të grupit!
  - Ngjitni të gjitha pjesët në skicën e emblemës tuaj!
  - Gjeni një simbol të përbashkët për grupin tuaj (në mes), një moto për idetë tuaja (pjesa e sipërme e flamur) dhe një emër për grupin tuaj (pjesa e poshtme e flamurit).
4. Emblemat e përfunduara paraqiten nga një anëtar i grupit në seancë plenare. Emblemat varen në mur pranë njëra tjetrës. .

# Materialet





## Ushtrimi 1.4. Një tufë me lule

<b>Objektivat mësimore</b>	Qëllimi i ushtrimit është që të përkrahë kohezionin e grupit dhe të rritë vlerësimin për veten. Nxënësit vlerësojnë se individët në një grup janë të unikë dhe të ndryshëm, por që ndihmojnë në fuqizimin tërësor të grupit.
<b>Burimet</b>	Një fotografi e vogël portret e nxënësit, jo më e madhe se 3 cm katrorë (është i pranueshëm edhe një autoportret i vizatuar)  Letër e verdhë ose portokalli e prerë në copa të rrumbullakëta me diametër rreth 6 cm për të krijuar zemrën e lules.  Letra me ngjyra të ndritshme, të prera në trajtën e petaleve, fjongo të ngjyrosur, qoftë edhe e vizatuar me dorë, shënues ose lapsa me ngjyra të ndryshme, dy fletë të mëdha letre me madhësinë e atyre që përdorin piktorët, zamkë ose ndonjë ngjitës tjetër.

### Procedura

1. Çdo nxënës ka një copë të rrumbullakët letre ku ngjit fotografinë e tij.
2. Çdo nxënës merr gjashtë petale dhe në secilën prej tyre shkruan një ose dy fjalë pozitive mbi:
  - çfarë mund të thotë mësuesi për nxënësit?
  - çfarë mund të thotë një anëtar mashkull i familjes së tyre për ta?
  - çfarë mund të thotë një anëtare femër e familjes së tyre për ta?
  - çfarë thonë për veten?
  - çfarë mund të thotë një mik rreth tyre?
  - çfarë mund të thotë dikush tjetër në dhomë, shkollë ose shoqëri për ta?
3. Nxënësi ngjit petalet përreth anëve të fotografisë për të krijuar një kurorë lulësh.
4. Mësuesi ose nxënësit rregullojnë kurora lulësh në letrën reklamuese.
5. Mësuesi ose nxënësit vizatojnë kërcejtë dhe gjetet për çdo lule që të krijojnë një buqetë.  
Lidhja e një fjongoje prej shiriti e bën tufën e luleve do të bënte ata mjaft të veçantë!

### Zgjerim

Nxënësit, të ulur në trajtë rrethi, japin komentet e tyre. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë domethënien simbolike: buqeta do ta humbte bukurinë sikur të mungonin disa lule (bashkësia); çdo lule është e ndryshme dhe shton diçka të papërsëritshme (dinjitetin e personit); në të njëjtën kohë, të gjitha lulet janë të ngjashme e, prandaj, çdonjëra prej tyre është po aq e rëndësishme sa edhe të tjerat (barazia). Në klasat me nxënësit më të vjetër mund të përfshihen konceptet në kllapa.

## Ushtrimi 1.5. – Shkopinjte kineze

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit të stërviten për të zotëruar aftësitë e lojtarëve të ekipit. Ata përjetojnë se çfarë do të thotë të varesh nga të tjerët dhe këta të kenë nevojë të varen prej tyre (ndërvarësia).
<b>Burimet</b>	Shkopinjte kinezë ose lapsa, stilolapsa etj. (rreth 15 cm të gjatë).


### Procedura

1. Klasa ndahet në grupe me rreth tetë nxënës secili. Grupeve u thuhet se atyre u duhet të përshkrijnë një largësi të caktuar (nëse ka mundësi, ushtrimi duhet të bëhet jashtë ndërtesës së shkollës).
2. Grupet qëndrojnë në rreshta, rreth 1–1.5 metra larg tyre.
3. Nxënësit i mbajnë shkopinjte kinezë (ose stilolapsa, lapsa) te majat e gishtërinjve tregues. Tanimë shkopinjte i lidhin nxënësit së bashku.
4. Tani grupet duhet të vrapojnë drejt një synimi të vendosur që më parë, për shembull, klasa apo skaji i oborrit të shkollës. Nëse dy nxënësve u bien shkopinjte, tërë skuadra duhet të kthehet në pikën e nisjes dhe t'ia fillojë përsëri prej andej. Skuadrat janë të lira për të zhvilluar teknikën dhe strategjinë më të mirë për të lëvizur me shpejtësi drejt pikësnyimit pa u rënë shkopinjte.  
Këto rregulla, mund të zbatohen pak a shumë me përpikëri, pavarësisht sa e vështirë mund të jetë kjo detyrë për nxënësit.

### Shtojcë

1. Disa nxënës mund të veprojnë si vëzhgues të jashtëm, që mund të japin mendimet e tyre për mënyrën e bashkëpunimit të grupeve me njëra-tjetrën.
2. Veprimtaritë mund të filmohen për të treguar format e ndryshme të sjelljes.

## Kapitulli 2 – Qartësimi i vlerave



### Hyrje

Në shoqërinë e sotshme, ne mund dhe duhet të zgjedhin vlerat që besojmë se janë të rëndësishme dhe kuptimplote për ne. Duke bërë zgjedhje të tilla, ne përdorim lirinë tonë të personit, mendimit, besimit si dhe lirinë e shprehjes kur tregojmë pikëpamjet tona në publik. Prandaj, ushtrimet në këtë kapitull trajtojnë një parim kyç të të drejtave të njeriut: lirinë e personit ose të individit.

Sikurse tregohet me anë të ilustrimit, liria vetjake vjen bashkë me nevojën për të bërë zgjedhje. Njerëzit e lirë mund të jenë tmerrësisht të vetmuar. Askush nuk mund dhe nuk duhet të na thotë se çfarë të besojmë ose çfarë vlerash duhet të zgjedhim. Por, ne duhet të zgjedhim – përndryshe si do ta marrim vesh se çfarë është e rëndësishme në jetë? Prandaj, zgjedhja e vlerave është një çështje kryesore për të rinjtë, në përpjekjet e tyre për t’iu përgjigjur pyetjeve: Kush jam unë? Cili është identiteti im?

Nga pikëpamja e nevojave të shoqërisë në tërësi, ne zbulojmë se liria e individit të çon në një shoqëri pluraliste, ku anëtarët e saj mbështetin vlera dhe bindje të ndryshme. Por, pluralizmi mund të jetë edhe burim konflikti. Kjo bën që të lindë pyetja se në cilat vlera mbështeten shoqëria dhe demokracia jonë; për shembull, vlerësimi i kompromisit, mospërdorimi i dhunës apo përfshirja e pakicave). Zakonisht, nëse anëtarët e një shoqërie ia dalin të merren vesh në lidhje me rregullat e argumentimit paqësor dhe të vendimmarrjes, atëherë ata mund të përballojnë mjaft çështje kundërshtuese që lidhen me pikëpamjet dhe interesat e tyre.

Të gjitha këto çështje janë njësoj të rëndësishme në mikro-shoqërinë e një klase shkolle dhe për gjithë shoqërinë në përgjithësi. Në një shoqëri demokratike, asnjë individ ose pushtet nuk ka të drejtën të caktojë vlera për të gjithë. Përkundrazi, qytetarët do të zhvillojnë bisedime për të arritur një marrëveshje, sado të vogël, për disa vlera. Andaj, s’është punë e mësuesit të përcaktojë vlerat nga pikëpamja e korrektësisë politike, e ndonjë partie, bindje a ideologjie të veçantë. Nxënësit duhet të mësojnë se si ta shfrytëzojnë lirinë e tyre të mendimit dhe si t’i ndajnë zgjedhjet e tyre me të tjerët.

Këto ushtrime i mbështetin nxënësit në zhvillimin e aftësive për të zhvilluar bisedime. Ata ndërgjegjësohen për parimin themelor të prapësimimit. Ata e kuptojnë se zgjedhja e vlerave ka të bëjë shumë me gjendjen shoqërore dhe mbrojtjen e interesave tona. Në çdo ushtrim, mënyra si nxënësit argumentojnë, në mënyrë paqësore dhe në respekt të ndërsjellë, është po aq e rëndësishme sa edhe vetë çështja për të cilën ata argumentojnë pro apo kundër.

## Ushtrimi 2.1. Loja me trap

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit njihen me nocionin e vlerave. Nxënësit mësojnë si t'i identifikojnë paragjykimet
<b>Burimet</b>	Loja me letra jep informacion në lidhje me personazhet.

### Procedura

Nëntë persona janë lënë në mëshirë të fatit mbi një trap, në det të hapur. Ata nuk e dinë vendndodhjen e tyre të saktë. Trapi nuk i nxë të gjithë dhe, për këtë arsye, katër prej tyre duhet të hidhen në det.

Kush do të jenë ata dhe pse?

Çdo nxënës merr një kartë, në të cilën janë dhënë disa të dhëna për personazhin që ai ose ajo do të luajë.

Ky nuk është vetëm një lojë me role, por edhe një çështje identifikimi me personazhin, duke gjetur edhe arsyet që ai meriton, më shumë se të tjerët, për të mbijetuar. Ata duhet të përdorin gjithmonë vetën e parë «Unë». Në kartë janë treguar edhe situata dhe kush është në rrezik. Gjatë kësaj faze të parë prej dhjetë minutash, qetësia duhet të jetë absolute.

1. Nxënësit punojnë në grupe me nga katër deri në gjashtë veta.  
Secili grup vendos se kush duhet të shpëtohet, në bazë të argumenteve të paraqitura nga çdo nxënës. Për të rritur ndërveprimin, çdo person duhet të mbrojë, jo vetëm personazhin e tij, por edhe të sulmojë personazhin tjetër. Megjithatë, vendimi i përbashkët duhet të merret brenda njëzet minutave
2. Secili grup bën të ditur zgjedhjet e tij, të cilat i krahason me ato të grupeve të tjera.
3. E gjithë klasa identifikon vlerat dhe paragjykimet që dolën gjatë veprimtarisë .

### Materialet

#### Disa shembuj personazhesh të ndryshme

Një bojaxhi 35-vjeçar, beqar, që është aktiv në një lëvizje politike	Një cigan që sapo ka dalë nga burgu
Një prostitutë me HIV-pozitiv	Një e moshuar, një vejushë, që, me kursimet e veta, udhëton për në vendlindjen e vet, për të takuar prapë të birin
Një pianist rus, baba i dy fëmijëve	Një i ri anglez kokërruar i dehur
Një i ri 15-vjeçar, fitues i një çmimi të rëndësishëm në letërsi	Një lojtar bejsbolli, i vjetër e i njohur, amerikan
Një ambasador që punon për Kombet e Bashkuara	Një nënë e re që ka thyer njëren këmbë
Një ushtar që kthehet me leje nga ushtria	

## Ushtrimi 2.2. – Sistemi i vlerave

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit zbulojnë se vlerat e ndryshme janë një burim përplasjesh të mundshme.
<b>Mjetet</b>	Letër dhe stilolapsa, një fletë pune që përmban një listë vlerash të ndryshme.

### Procedura

Çdo nxënësi i jepet një listë me 20 vlera, jo sipas një renditjeje të veçantë: sukcesi shoqëror, dashuria, bindja, siguria, paqja, rendi, dinjiteti i njeriut, vlerësimi për veten, barazia, vlerësimi për të tjerët, ndershmëria, familja, solidariteti, përgjegjshmëria, drejtësia, duresa, liria, konkurrenca, shëndeti, atdhetarizmi.

1. Nxënësit punojnë në çifte.
2. Mësuesi kërkon që nxënësit t'i grupojnë vlerat në tri kategori. « Në grupin e parë, vendosni ato që ju duken më të rëndësishme; në grupin e dytë, ato më pak të rëndësishme; dhe, në fund, ato që nuk mund të grupohen.» Kjo punë duhet të bëhet ngadalë dhe me vëmendje.
3. Nxënësit japin mendimet e tyre në çifte, që duke i këmbyer për të krijuar çifte të reja. Hierarkia nuk parapëlqehet nga asnjë çift. Në këtë veprimtari, nxënësit nuk vlerësohen me notë ose me forma të tjera. Mësuesi duhet të theksojë ndryshimin ndërmjet vlerave ideale të thjeshta dhe atyre të frytshme – ato që marrin parasysh një lloj sjelljeje.
4. Kërkojuni nxënësve të ruajnë listën me zgjedhjet e tyre të para.

### Shtojcë

1. Nxënësit formojnë grupe me nga tre veta dhe krahasojnë sistemet e tyre përkatëse (lista e zgjedhjes së parë), duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:
  - Përse e kam zgjedhur këtë vlerë si më të rëndësishmen?
  - A ka kjo vlerë ndonjë rëndësi për sjelljen time të vërtetë?
  - Cilat janë pengesat për arritjen e saj?
  - Cili është konflikti im kryesor?
  - Çfarë mund të bëj për ta zgjidhur atë?
  - Cilat janë qëndrimet individualiste, të kundërta me angazhimet e vërteta kolektive?
2. Nxënësit grupojnë vlerat sipas kategorive, për shembull, etika e përgjithshme ose të drejtat e njeriut, përdorimi i praktik, sukcesi i përgjithshëm ose shoqëror. Cili grupim duket se është më i rëndësishmi? Individit, kur ballafaqohet me zgjedhje, mund të veprojë pa u menduar, sipas zakonit, ose i nxitur nga ato që duken se janë arsyet më të mira për të vepruar. Ne mendojmë për vlerat kur kërkojmë të zgjedhim qëllimet dhe jo mjetet më të mira për arritjen e tyre.
3. Ky proces mundëson një zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët që ballafaqohen me argumente të kundërta kur ka konflikt interesash. Edhe pse shpesh, shtyhem i përdorim moralin për të mbrojtur interesat vetjake, disa parime janë të nënkuptuara dhe në veprim. Respekti për individin është një parim, një rregull, që e bën të mundshëm pranimin ose mospranimin e një kategorie veprimesh të caktuara. Kriteri më i besueshëm për të ditur nëse një rregull i sjelljes ndihmon në respektimin e individit është prapësimi. Kjo na bën t'i japim po aq rëndësi interesave të të tjerëve sa edhe tonave.

Nxënësit, në grupe, duhet të formulojnë disa parime të tilla si:

- Ligji duhet zbatuar gjithmonë
- Të gjithë kanë të drejtë të jetojnë jetën si t'u duket më mirë.

Pastaj, ata mund të identifikojnë pikëpamjet e shprehura dhe parimet kryesore.

## Ushtrimi 2.3. – Filozofia e jetës

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit kuptojnë se vlerat kanë rëndësi të ndryshme praktike
<b>Mjetet</b>	Një listë me jetë të ndryshme në një afishe ose në dërrasën e zezë.

### Procedura

1. Nxënësit vlerësojnë çdo «mënyrë të jetës» me ndihmën e shkallës së mëposhtme:
  - 7 – E pëlqeni shumë
  - 6 – E pëlqeni
  - 5 – E pëlqeni plotësisht
  - 4 – Jeni moskokëçarës ndaj saj
  - 3 – Nuk ju bëhet vonë për të
  - 2 – Nuk e pëlqeni
  - 1 – Nuk e pëlqeni fare.
2. Mësuesi kërkon nga nxënësit të krahasojnë vlerësimin e tyre në çifte ose në grupe me tre ose katër vetash.

### Zgjerim

Nxënësit përshkrim me shkrim mënyrën ideale të jetës së tyre (ata duhet të përpiqen të shmangin së përshkruari mënyrën e tyre të jetës). Kështu zbulojnë se cilat janë kundërshtitë; a përputhen ato me shkallën e tyre të vlerave?

### Materialet


(Shih faqen në vijim)

### **Mënyra të ndryshme të jetës**

1. Cilësitë vijuese janë të nevojshme në jetë: përmbajtja, zgjuarsia, drejtpeshimi i ekstremeve, miqësia, vetëkontrolli, disiplina, largpamësia, mirësjellja dhe respekti për traditat e caktuara.
2. Çështjet kryesore në jetë janë: liria individuale dhe intelektuale, moskokëçarja ndaj interesave materiale dhe botës fizike.
3. Vetitë më të rëndësishme janë: dhembshuria, dashuria, përkushtimi, kontrolli i pasioneve dhe interesave, çiltërsia me të tjerët. Nuk duhet pasur besim te zgjuarsia për keq, dëshira për pushtet dhe egoizmi.
4. Të gëzosh jetën ka më tepër rëndësi se të ndryshosh botën; refuzimi etikës, i disiplinës dhe i vetëmohimit; nevoja për shoqëri, por me periudha vetmie.
5. Individit duhet të identifikohet me grupin dhe të kërkojë miqësinë e tij. Të qenit i shoqërueshëm dhe veprimi janë të rëndësishme, ashtu sikundër hedhja poshtë e përsiatjes si abstraktim, për vetminë dhe interesat materiale. Parapëlqehen gjithmonë konkretizimi emocional pozitiv edhe kënaqësitë e përbashkëta.
6. Individët duhet të kërkojnë të merren me veprimtari fizike të bollshme, eksplorimin e botës së vet dhe të shqisave praktike, parapëlqimin për punë, hedhjen poshtë të ëndrrave që i ngjallin mallin për të kaluarën, kundërshtimin e rehatisë dhe vetëkënaqësisë.
7. Megjithëse ditët ndjekin njëra-tjetrën, ato janë krejt të ndryshme nga njëra-tjetra. Paqëndrueshmëria dhe përshtatja janë kryesore, andaj njerëzit duhet të kenë dëshirën të gëzojnë çdo çast të rëndësishëm të jetës. Mbi të gjitha, mos bjerë skllav i një ideje të vetme.
8. Kënaqësitë e thjeshta janë të rëndësishme: rehatia, miqësia, çlodhja, shëndeti i mirë, kundërshtimi i kënaqësive të forta e të ndërlikuara, hedhja poshtë e ambicies dhe fanatizmit.
9. Çiltërsia dhe mendjemprehtësia janë të domosdoshme: kënaqësia dhe suksesi vijnë vetë; prit me qetësi dhe mendjemprehtësi.
10. Njerëzit duhet të kenë vetëkontroll, por duhet të hapin sytë, të jenë të vetëdijshëm për fuqinë e të tjerëve dhe kufizimet e vetë njeriut. Ata duhet të jenë bujarë, por jo utopikë, dhe në jetë duhet të ecin me vetëkontroll dhe dinjitet.
11. Shqyrtimi është i rëndësishëm. Bota është tepër e madhe dhe mjaft agresive. Jeta shpirtërore është thelbësore dhe ka përparësi mbi një botë të pavlerë dhe sipërfaqësore, që duhet të hidhet poshtë.
12. Vëmendja duhet përqendruar te: veprimi, ekzekutimi, sfida, ndërtimi; trupi, duart, muskujt janë jeta e vërtetë. Maturia, rehatia dhe çlodhja duhen të hidhen poshtë.
13. Qeniet njerëzore rrojnë për të shërbyer: t'u sjellësh dobi të tjerëve duke nxitur mbarëvajtjen e tyre vetjake. Jepu plotësisht pas botës; ji i përrulur, i qëndrueshëm, besnik, i epshëm. Prano pa bërë pyetje, puno për sundimin e së Mirës.



## Kapitulli 3 – Njohja me të drejtat e njeriut



### Hyrje

Ilustrimi tregon një sërë objektesh që janë të njohura për fëmijët dhe të rinjtë. Secili prej tyre mund të lexohet si simbol që shpreh një të drejtë të njeriut ose të fëmijës – një tendë (koha e lirë), një çadër (mbrojtja), një pjatë me ushqim (nevojat fizike), një libër (edukimi, liria e mendimit), një arushë pelushi (koha e lirë dhe të luajturit), një flamur (mbrojtja e të drejtave të qytetarëve nga shteti), çanta e ndihmës së shpejtë (kujdesi mjekësor), një zarf (liria e fjalës dhe e të shprehurit), një shtëpi (privatësi). Globi mund të shprehë idenë e mbrojtjes të të drejtave të njeriut për çdo qenie njerëzore. Simbolet janë rregulluar, këndshëm, mbi njëri-tjetrin dhe mund t'i përfytyrojmë sikur rrotullohen. Në këtë mënyrë, ato lidhen në një strukturë të vetme, që përbëhet dhe nënkupton më shumë se pjesët e saj. Nëse masës së përftuar i heqim qoftë edhe vetëm një element, e gjithë struktura do të shembet.

Kjo pikturë është një shembull që tregon se sa të fuqishme, mund të jenë simbolet, në dukje të thjeshta. Gjetja e simboleve për të drejtat e njeriut është një ushtrim që mund t'i jepet çdo nxënësi fare të ri, sikurse, afërmendsh, edhe më të mëdhenjve. Kjo u lejon atyre të lidhin përvojën e tyre me të drejtat e njeriut dhe të zbulojnë domethënien e të drejtave të njeriut për jetën e tyre dhe disa nga ushtrimet në këtë kapitull ndjekin këtë drejtim.

Ushtrimet në këtë kapitull kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut – ato janë thelbi i edukimit për të drejtat e njeriut. Kapitujt e tjerë, për shembull, ato që flasin për vlerat, e vënë theksin te mësimdhënia përmes të drejtave të njeriut, gjë që mund të shfrytëzohet si udhëzues pedagogjik. Këto ushtrime përqendrohen në mësimdhënien rreth të drejtave të njeriut:

- njohja e të drejtave të njeriut: nxënësit njohin me hollësi, p.sh., njërën ose disa nga të drejtat e njeriut dhe kuptojnë parimet themelore;
- leximi për të drejtat e njeriut – ngadalë dhe me kujdes, në mënyrë që çdo fjalë të ketë kuptim;
- lidhja e të drejtave të njeriut me jetën e

përditshme; nxënësit shohin përvojën e tyre, nevojat dhe dëshirat e tyre nga pikëpamja e të drejtave të njeriut.

Kjo qasje është e përshtatshme për nxënësit e çdo moshe.

Disa ushtrime janë shembuj të të mësuarit me bazë detyrën. Nxënësit bëjnë një afishe ose një arkë kursimi dhe krijojnë simbole që paraqitin disa drejta të njeriut. Ushtrime të tilla, që nxitin aftësitë krijuese të nxënësve, përbëjnë një ndryshim nga qasja e zakonshme e mbështetur mbi tekstin.

Të gjitha ushtrimet kërkojnë reflektime të kujdesshme në klasë. Nxënësit duhet të kuptojnë se, të drejtat e njeriut mund të dhunohen, dhe për këtë arsye, ato duhet të mbrohen nga ligjet dhe institucionet e zbatimit të ligjit (policia, burgjet etj.).

Me nxënësit më të rritur është e mundur të ndërmerren disa hapa të mëtejshme. Të drejtat e njeriut janë të drejta themelore, që do të thotë se asnjë autoritet nuk ka nevojë t'i dhurojë këto

të drejta ose të gëzojë një pozitë të tillë të na i marrë ato. Nxënësit duhet të vihen në dijeni të qenies së traktateve të të drejtave themelore të njeriut të tilla si: Konventa për të Drejtat e Njeriut. Lipset që ata të kuptojnë se të drejtat tona kanë kufij që janë vendosur nga të drejtat e të tjerëve. Ne kemi nevojë të gjejmë se si ta bëjmë këtë dhe, në e lyptë nevoja, ligjvënësit dhe gjyqtarët do të duhet të marrin vendime për këtë gjë. Siç e tregojnë raportet e Këshillit të Evropës ose të organizatave joqeveritare (OJF), vetë shteti mund të jetë kërcënim për të drejtat e njeriut. Në raste të tilla, qytetarët mund t'u drejtohen gjykatave të tyre kombëtare kushtetuese ose Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

## Ushtrimi 3.1. Afishja e të drejtave të njeriut

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit kuptojnë aspektet e mëposhtme të të drejtave të njeriut: struktura e tyre themelore (kush i gëzon të drejta e njeriut – përmbajtjen e secilës prej tyre – mjetet e vënies së tyre në jetë); problemi i shkeljes të të drejtave të njeriut; mjetet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nxënësit ushtrojnë aftësitë e tyre të leximit. Nxënësit zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese
<b>Burimet</b>	Tabakë të mëdhenj letre, letra me madhësinë A4, me ngjyra të ndryshme, markera, gërshërë, ngjitës, gazeta dhe revista të vjetra, piktura dhe fotografi; tekstin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ose të Deklaratës Universale e të Drejtave të Njeriut.

### Procedura

1. Nxënësit formojnë grupe me nga katër veta.
2. Mësuesi cakton një nen që paraqet një prej të drejtave të njeriut. Nxënësit më të rritur mund të vendosin vetë se me cilin nen dëshirojnë të merren dhe të shpjegojnë zgjedhjen e tyre (shih hapin 4).
3. Secili grup përgatit një afishe për një të drejtë njerëzore. Afishja përbëhet nga pjesët e mëposhtme:
  - a. emërtimi i caktuar për një nga të drejtat e njeriut;
  - b. teksti i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose i Deklaratës Universale të të Drejtave të njeriut;
  - c. një fotografi që simbolizon një nga të drejtat e njeriut (p.sh., një makinë mund të paraqitë lirinë e lëvizjes ose dera kryesore e shtëpisë, e mbyllur, mund të shprehë jetën private);
  - d. analiza e strukturës të të drejtave të njeriut (për klasat e larta), në lidhje me:
    - personat që e gëzojnë këtë të drejtë;
    - përmbajtjen (atë që mbron ose plotëson kjo e drejtë);
    - mjetet e plotësimit ose të zbatimit;<sup>3</sup>
  - e. një simbol (p.sh., një rrotë për lirinë e lëvizjes ose buzët për lirinë e shprehjes).
4. Grupet paraqesin dhe shtjellojnë afishet e tyre në klasë.

### Zgjerim

Afishja mund të përmbajë edhe shembuj të shkeljeve të të drejtave të njeriut në fjalë dhe si mund ose duhet të zbatohet.

### Variacion

Siç tregohet më sipër, përmbajtja e afishes mund të ndryshohet në përputhje me grupmoshën dhe njohuritë e nxënësve për të drejtat e njeriut. Ushtrimi mund të shërbejë si hyrje ose si zbatim.

Për klasat e përparuara, ushtrimi mund të përfshijë aspekte të tilla si: tipi i së drejtës së njeriut (dhënia e lirisë individuale, mbrojtja e barazisë, zbatimi i të drejtave shoqërore). Këto mund të kenë lidhje me «brezat» e të drejtave të njeriut.

---

<sup>3</sup> Shiko Yves Lador, *Teaching Guide to European Convention on Human Rights*, Gjenevë/Strasburg, 1997, f. 53f (Si krijohet një e drejtë njerëzore?).

Ky ushtrim, në vetvete, mund të çojë në një qasje të veçuar akademike, që përqendrohet vetëm në një të drejtë njerëzore. Për këtë arsye, këshillohet që ky ushtrim të ndërthuret bashkë me të tjerët, që bëjnë fjalë për procesin e të drejtave të njeriut, për shembull, me përvojën vetjake e nxënësve, me çështjen e shkëljes dhe zbatimit të të drejtave të njeriut dhe me shtjellimin e natyrës universale të të drejtave të njeriut.

## Ushtrimi 3.2. Spango

<b>Objektivi mësimor</b>	Qëllimi i këtij ushtrimi është që të paraqitë një këndvështrim global të prejardhjes dhe të shtëpisë së përbashkët, si një hyrje në edukimin për të drejtat e njeriut. Të gjithë njerëzit kanë të njëjtën prejardhje, jetojnë në të njëjtën tokë dhe kanë të njëjtat të drejta, pavarësisht se ku jetojnë apo në ç'gjendje janë. Duke i bërë të dukshme shifrat e mëdha, ky ushtrim i bën ato më të kuptueshme për fëmijët.
<b>Shënim mbi metodën</b>	Vlera e këtij ushtrimi qëndron më shumë në modelin e ligjërimit të mësuesit se sa të punës në grup.
<b>Burimet</b>	Dy fije spango, 4.8 dhe 7 m të gjata, mundësisht një hartë bote ose një rruzull.

### Procedura

1. Mësuesi u tregon nxënësve një spango ose litar 4.8 metra të gjatë dhe kërkon prej tyre të hamendësojnë gjatësinë. Mbase nxënësit vijnë në një mendje se spango është 4.8 metra e gjatë, atëherë i pyet ata të llogarisin gjatësinë në milimetra.
2. 4800 milimetra mund të simbolizojnë historinë e tokës tonë, pasi hamendësohet se ajo është 4 milionë e 800 mijë vjet e vjetër.
3. Mësuesi kthehet prapa në krijimin e planetit dhe përshkruan ngjarjet kryesore të historisë së tokës, 1 milimetër shpreh 1 milion vjet. Sa kohë kanë qeniet njerëzore në këtë tokë? Mësuesi u tregon atyre 1–2 milimetrat e fundit dhe këtë e krahason me pjesën tjetër të spangos. Mos ndoshta njerëzit nuk janë edhe aq të rëndësishëm? Mos ndoshta duhet të tregohemi mjaft të kujdesshëm që të kujdesemi për planetin ku jetojmë në të?
4. Mësuesi u tregon nxënësve diçka për historinë e njeriut. Me sa dimë, qeniet njerëzore e kanë prejardhjen në Afrikë. Në fillim, të gjithë ne kemi qenë afrikanë! Pastaj, njeriu shtegtoi nga Afrika dhe, përfundimisht, populloi tërë tokën. Sot, ne jemi shumë vende dhe mjaft grupe të ndryshme, që flasim shumë gjuhë të ndryshme dhe kemi fe dhe kultura të ndryshme, por, fillimisht, kemi qenë të gjithë të njëjtë.
5. Mësuesi u tregon nxënësve fillin e dytë. Sa i gjatë është ai? Sot ne jemi rreth 7 miliardë njerëz në tokë.<sup>4</sup> Kështu që 1 milimetër i spangos përkon me 1 milion njerëz. Mësuesi tregon madhësinë e disa prej vendeve më të mëdha në spango. Cila është madhësia e vendit tonë? Disa njerëz duket se botën e ndajnë në «njerëzit tanë» dhe «të huajt». Spango na tregon se shumica e njerëzve janë «të huajt»! Por, të gjithë ne e përdorim këtë planet si shtëpinë tonë dhe duhet të mësojmë si të jetojmë së bashku në të. Vendet e ndryshme të botës, përmes Organizatës së Kombeve të Bashkuara, kanë vendosur që edhe pse jemi të ndryshëm dhe banojmë në vende të ndryshme, të tërë të kemi të drejta njerëzore të njëjta.

### Zgjerim

Mësuesi, mund të shfrytëzojë këtë hyrje, për të shtjelluar çështjet e mjedisit, të drejtave të njeriut në përgjithësi, paragjykimet dhe stereotipat (shih kreu «Të kuptosh të tjerët»), çështjet gjeografike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

---

<sup>4</sup> Mësuesi duhet ta përditësojë këtë shifër nëse është e nevojshme dhe të përshtatë gjatësinë e fillit; kur ky libër u fut për herë të parë në shtypshkronjë (2008), popullsia e botës ishte 6.7 miliardë njerëz.

### Ushtrimi 3.3. – Pema e të drejtave të njeriut

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit zhvillojnë një kuadër konceptual për të gjykuar të drejtat e njeriut
<b>Materialet</b>	Stilolapsa me ngjyra, tabakë letre për t'i vënë në mur.

#### Procedura

1. Mësuesi i ndan nxënësit në grupe të vogla me nga tre deri në pesë veta.
2. Mësuesi u kërkon nxënësve të vizatojnë një pemë të bukur dhe ta quajnë «pema e të drejtave tona njerëzore». Pranë fundit të trungut të pemës, nxënësit duhet të shkruajnë «të drejtat e njeriut».
3. Pastaj pema duhet të pajiset me disa degë që përmbajnë disa nga konceptet kryesore që nxënësit besojnë se janë ose duhet të përfshihen tek të drejtat e njeriut. Rreth degëve kryesore mund të jetë një numër degësh më të vogla për gjërat që ata besojnë se kanë lidhje me degët kryesore.
4. Pas një kohe të caktuar, grupet varin vizatimet e tyre në mur dhe u shpjegojnë të tjerëve ato që kanë shkruar në to. Këto afishe mund të lihen për disa kohë në mur. Ato do të shërbejnë si zbukuruese dhe, pse jo, mund të përdoren përsëri si mjete gjatë orëve të tjera mësimore.

#### Shtojcë

Mësuesi, pasi mëson për idetë e nxënësve rreth të drejtave të njeriut, mund të vazhdojë me studimin, më me hollësi, të të drejtave të njeriut ose të fëmijëve dhe të kuptojë, deri në ç'masë, të drejtat e tanishme përkojnë me ato që kanë shkruar nxënësit.

### Ushtrimi 3.4. – Udhëtim me balonë

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit vetëdijesohen për vlerat universale të të drejtave të njeriut. Ata e kuptojnë se disa të drejta të njeriut janë të përfshira në mënyrë të plotë tek të tjerat por, në brenda sistemit të të drejtave të njeriut, kjo përbën një dallim po qe se të drejtat e veçanta të njeriut janë të mbrojtura apo jo.
<b>Shënim mbi përdorimin</b>	Nxënësit kuptojnë se të drejtat e njeriut janë të patjetërsueshme, dhe se shfuqizimi i padrejtë i të drejtave të njeriut çon në diktaturë. Kjo lojë mund të përdoret si një hyrje në fillim të pjesës së mësimin mbi të drejtat e njeriut ose si një ushtrim që mund të lihet për në fund.
<b>Burimet</b>	Stilolapsa dhe letër, fletë mundësisht të mëdha për t'u vendosur në mur; lista e të drejtave që do të flaket/renditet sipas përparësisë.

#### Procedura

1. Mësuesi drejton lojën. Nxënësit formojnë grupe me nga pesë deri në gjashtë veta. Secili grup merr një afishe dhe lapustila. Nxënësit të vizatojnë një balonë me ajër të nxehtë mbi oqean ose mbi ndonjë peizazh lokal. Thasët me rërë, që simbolizojnë dhjetë të drejtat e njeriut, ngjiten në afishe. (shih listën e mëposhtme).
2. Tani fillon loja. Nxënësit duhet të përfytyrojnë sikur po udhëtojnë me «balonën e të drejtave të njeriut». Balona rrezikon të bjerë dhe udhëtarët duhet të heqin ca rërë për të shmangur ndonjë aksident të rëndë.  
Nxënësit duhet të vendosin përparësitë e të drejtave të njeriut të paraqitura nga thasët me rërë. Ata do të përdorin kriteret vijuese. A përfshihet një e drejtë plotësisht tek tjetra? A është e drejta konkrete me rëndësi të veçantë për demokracinë ose për nevojat tona vetjake?
3. Ndërkohë që nxënësit mendojnë për përparësitë, balona vazhdon të ulet dhe ata duhet të vazhdojnë të hedhin thasë (të drejta) të tjerë në intervale të rregullta. Vetëm pasi hidhen katër a pesë thasë, balona ulet në tokë në mënyrë të sigurt.
4. Reflektimi në «seancë plenare». Secili grup paraqet listën e vet para gjithë klasës/grupit dhe shpjegon (disa nga) përparësitë e veta. Pastaj listat mund të krahasohen. A ka shumë dallime mes tyre? Po ashtu, duhet të ketë një llogaridhënie të shkurtër lidhur me punën në grupe. A ishte e vështirë të binin në një mendje? A ishte e vështirë t'u jepej përparësi disa të drejtave të njeriut, në vend se të të tjerave? Urojmë që të pranohet se të gjitha të drejtat e njeriut, të renditura në listë, janë të rëndësishme, por njerëzit mund të kenë përparësi të ndryshme, në qoftë se do t'u duhet të zgjidhnin.  
Në një kushtetutë funksionale, shfuqizimi i ndonjë prej këtyre të drejtave do të shkaktonte dëme të rënda për demokracinë. Të drejtat e njeriut janë të drejta natyrore dhe prandaj të patjetërsueshme. Prandaj, udhëtimi me balonë që një simulim rreth një gjendjeje që urojmë të mos ndodhë kurrë – sundimin e ndonjë diktatori.  
Nëse nxënësit vënë në pikëpyetje rregullat e lojës, duke u bazuar në arsyetimin e mësipërm, atëherë mund të themi se objektivi i të mësuarit është arritur plotësisht.  
Reflektimi mund të zgjerohet, duke shqyrtuar se cila nga këto të drejta është përfshirë në kushtetutën e vendit dhe si mbrohen këto të drejta.

#### Zgjerim

Kur ushtrimi bëhet me nxënësit më të vegjël, thasët e rërës (të drejtat), duhet të shkëmbehen me gjëra më të njohura për ta, për shembull, «zgjedhjet e lira» mund të zëvendësohen me «lodra». Gjatë marrjes në pyetje, këto gjëra mund të lidhen me të drejtat e fëmijëve.

## **Materialet**

### **Informacioni**

Thasët në balonë përfaqësojnë të drejtat e mëposhtme:

- zgjedhjet e lira
- liria e pronës
- barazia e burrave dhe e grave
- një mjedis i pastër e i shëndetshëm
- pasja e ushqimit të shëndetshëm dhe e ujit të pastër
- e drejta e edukimit
- liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë
- veshje dhe strehim për të gjithë qytetarët
- jeta private pa ndërhyrje nga të tjerët
- liria e lëvizjes.



### Ushtrimi 3.5. – Dëshirat dhe nevojat

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit kuptojnë dallimin midis atyre që dëshirojnë ose që do të dëshironin dhe atyre për të cilat kanë vërtet nevojë.
<b>Materialet</b>	Letër, stilolapsa, gërshtë.

#### Procedura

1. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të vizatojnë, në copa letre, disa nga gjërat që ata mendojnë se u nevojiten (mësuesi mund t'i përgatitë copat në fjalë përpara mësimit ose t'i vërë nxënësit t'i presin vetë ato). Secili prej tyre mund të bëjë rreth 8–10 vizatime secili.
2. Kur vizatimet janë gati, mësuesi i ndan nxënësit në grupe.
3. Çdo grup duhet të merret vesh që të mbajnë vetëm pesë prej vizatimeve. Në tryezë duhen lënë vetëm pesë nga gjërat më të rëndësishme. Pastaj grupet i sqarojnë njëra-tjetrës se çfarë kanë zgjedhur. A kanë zgjedhur të gjitha të njëjtën gjë?

#### Zgjerim

Mësuesi shtrin në klasë një litar për nderjen e teshave, në të cilin, mbërthen me kapëse një numër vizatimesh. Ai diskuton me klasën se cilat nga vizatimet mund të hiqen, gjëra që nuk nevojiten vërtet. Në fund, te litari duhet të varen vetëm pesë vizatime. A mundet që nxënësit të merren vesh se cilat duhet të jenë ato?

### Ushtrimi 3.6. – Arka e kursimeve

<b>Objektivat mësimore</b>	Ky është një ushtrim për fëmijët nën gjashtë vjeç. Ata e kuptojnë që fëmijët kanë të drejta, e marrin vesh se të këto drejta ekzistojnë dhe është me rëndësi zbatimi i tyre.
<b>Burimet</b>	Arka e kursimit është një kuti tejet e bukur, të cilën fëmijët e kanë zbukuruar dhe mbushur vetë (me artikuj gazetash, piktografi të UNICEF që ilustrojnë drejtat e fëmijëve, kukulla dhe sende të ndryshme).

#### Procedura

1. Në fillim, kutia përmban:
  - dy vizatime që përfaqësojnë të drejtën e barazisë dhe të drejtën për t'u dhënë ndihmë personave të paaftë fizikisht ose mendërisht;
  - dy kukulla që përfaqësojnë fëmijë nga Guatemala.
2. Fëmijët, duke grumbulluar sende që përfaqësojnë të drejtat e fëmijëve dhe duke i vënë ato në arkën e kursimeve, kuptojnë rëndësinë e këtyre të drejtave. Projekti Arka e Kursimeve duhet të vazhdojë deri në fund të shkollës fillore.
3. Çdo nxënës, përveç arkës së madhe të kursimeve, ka arkën e vet të vogël të kursimeve.

## Kapitulli 4 – Të kuptojmë të tjerët



### Hyrje

Figura tregon një vajzë që shikon me thjerrë zmadhuese një djalë. Pamja e krijuar nga thjerra zmadhuese është e ngjashme, por jo e njëjtë me djalin në të vërtetë. Ky nuk e di se si duket pamja e tij. Figura e re mund të jetë e gabuar apo e vërtetë, madje mund të nxjerrë në pah më shumë hollësi se ato për të cilat djali është i vetëdijshëm ose do të donte të shfaqte. Si njëri, edhe tjetri, janë duke buzëqeshur, kështu që dallimet ndërmjet perceptimit dhe realitetit nuk duket se paraqesin një problem. Vajza qesh me pamjen e djalit dhe jo me djalin e vërtetë

Të gjithë ne i drejtojmë syzet tona zmadhuese, si të thuash, për te njerëzit e tjerë dhe pamjet e tyre i ruajmë në mendje. Njerëzit i gjykojmë nga këto pamje mendore. Ato janë lënda e parë nga të cilat krijojmë stereotipat. Të gjithë ne, nga thjeshtëzime të tilla, vizatojmë botën e ndërlikuar, të cilën askush nga ne nuk është në gjendje ta kuptojë plotësisht. Nëse stereotipat shndërrohen në paragjykimet, sidomos negativë, atëherë ato mund të mbjellin përçarje dhe armiqësi në shoqëri.

Ushtrimet në këtë kapitull i ndihmojnë nxënësit të bëhen të vetëdijshëm për perceptimet e tyre dhe për paragjykimet e të tjerëve, për të reflektuar në mënyrë kritike për to dhe për t'i ndrequr nëse është e nevojshme. Prandaj, ky kapitull përqendrohet në shkallën shoqërore të demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Perceptimet tona të përbashkëta, paragjykimet dhe mënyrat e bashkëveprimit me njëri-tjetrin, sigurojnë themelin mbi të cilin duhen ngritur demokracia dhe të drejtat e njeriut. Nuk mjafton që demokracia dhe të drejtat e njeriut të parashtrihen si të vetmet parime të rëndësishme të qeverisjes dhe të kushtetutës; edhe rrënjët e tyre shoqërore dhe kulturore janë njëlloj të rëndësishme.

Në përgjithësi, nxënësit duhet të kuptojnë veprimin e stereotipave në uljen e shkallës së kompleksitetit të shoqërive tona dhe të botës ku jetojmë. Ata duhet të kuptojnë se stereotipat mund të jenë të rrezikshme, pasi mbjellin farën e armiqësisë në shoqëri. Kjo mund të ndodhë, sidomos, kur përballemi me njerëzit të huaj, që na ngjallin ndjenjën e frikës. Edukimi i ndihmon njerëzit të identifikojnë paragjykimet dhe stereotipat mashtruese dhe t'i ndreqin ato.

Nxënësit më të rritur mund të kuptojnë se perceptimet dhe paragjykimet tona në fund ndihmojnë për një kulturë që, ose mbështet, ose minon, demokracinë dhe të drejtat e njeriut në një bashkësi. Në kuptimin e vërtetë të fjalës, demokracia fillon me mua dhe ju.

## Ushtrimi 4.1. – Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit mësojnë të njohin dhe ta pranojnë njëri-tjetrin në një grup. Ata zbulojnë se kanë më shumë të përbashkëta në krahasim me atë që ishin të vetëdijsëm. Nxënësit bëhen të vetëdijsëm për qëndrimet dhe praktikrat që kanë lidhje me një dallim të caktuar.
<b>Burimet</b>	Një copë shkumësi ose një fill spangoje për të bërë një vijë në terren.

### Procedura

1. Mësuesi përmend një sërë tiparesh një nga një. Sapo të përmendet ajo, ata që pranojnë se kanë tipare të tilla kalojnë vijën.

Shembuj: të gjithë ata që...

- kanë veshur xhinse
- i kanë sytë të kaltër
- janë më të mëdhenj
- kanë vizituar vende të tjera të Europës
- lexojnë rregullisht një gazetë
- i janë nënshtruar diskriminimit
- kanë miq homoseksualë
- kanë paragjykime etj.

Nxënësve mund t'u kërkohet të sugjerojnë tipare, por mësuesi duhet të jetë i vetëdijsëm për ato që mund të jenë të ndjeshme për një pjesë të klasës.

2. Nxënësit diskutojnë për çështjet e mëposhtme:

- A e ka parë ndonjëherë veten dikush në një grup me dikë tjetër, me të cilin ka menduar se nuk ka asgjë të përbashkët?
- Si ndihesh kur je pjesë e një grupi të madh?
- Si ndihesh kur je vetëm?

### Variacion

Sapo përmendet një tipar, nxënësit futen në klasë për të formuar grupe të përbëra nga persona që kanë tipare të njëjta. Ata qëndrojnë së bashku për një çast për të shqyrtuar se çfarë kanë të përbashkët. Për shembull, ajo që ata thonë rreth parapëlqimeve dhe sjelljes.

## Ushtrimi 4.2. – Ndryshimet

<b>Objektivat mësimore</b>	<p>Nxënësit i ndiejnë ndryshimet dhe e kuptojnë se ato janë të rrënjësura në përbërjet shoqërore.</p> <p>Përjetimi i ndryshimeve është vendimtar në adoleshencë. Të rinjtë duan të tërheqin vëmendjen, të përfillen nga të rriturit dhe të nderohen nga njerëzit e tjerë. Një anë e rëndësishme e formimit të identitetit në adoleshencë është ndarja nga të rriturit, sidomos nga prindërit.</p> <p>Nxënësit kuptojnë ndryshimet biologjike janë aq të shumta, sa që kurrkush nuk mund t'i identifikojë të gjitha ato. Për shembull, nuk është e mundur të thuhet se një formë inteligjence qëndron më lart se një tjetër. Dallimet që kanë rëndësi mes njerëzve janë të rrënjësura në shoqëri, për shembull: vlerat, statusi ose ndryshimet shoqërore. Në ato klasa, ku nxënësit u përkasin pakicave kulturore, krijohet një mundësi e mirë që nxënësit t'i shfaqin ato në një kontekst jo diskriminues.</p>
<b>Materialet</b>	Një tabak i madh letre

### Procedura

1. Mësuesi shënon në listën e një flete të madhe letre sa më shumë lloje dallimesh mes njerëzve që të mundet.
2. Klasa ndahet në katër grupe. Çdo grup fut në listë një lloj dallimi të veçantë:
  - dallime fizike
  - dallime psikologjike
  - dallime shoqërore
  - dallime kulturore.
3. Vlerësimi: nxënësit mendojnë për dallimet mes njerëzve:
  - «Ma do mendja që e di...»
  - «... por kam mësuar...»
  - «E papritura më e madhe ishte...»

### Zgjerim

Mësuesi shpjegon pse njerëzit edhe ngajnë, edhe ndryshojnë nga njëri-tjetri.

Nxënësit përfytyrojnë, dhe hedhin në letër, dy situata në të cilat është e vështirë të përjetohen dallime. Më tej, kjo mund të diskutohet me tërë klasën.

## Ushtrimi 4.3. – Të vërteta dhe të rreme

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për stereotipat dhe i vlerësojnë ato në mënyrë kritike. Ata e kuptojnë se thjeshtëzimet dhe stereotipat na ndihmojnë të përballemi me botën e koklavitur në të cilën jetojmë. Nxënësit zhvillojnë aftësitë për të dhënë gjykime dhe për të marrë vendime. Në këtë mënyrë, ata nxiten të zhvillojnë qëndrimin kritik.
<b>Burimet</b>	Nga klasa nxirren bankat dhe karriget. Në anët e kundërta të klasës përcaktohet një hapësirë «e vërtetë» dhe një «e rreme».

### Procedura

1. Nxënësit qëndrojnë në mes të dhomës. Mësuesi lexon një varg pohimesh të vërteta dhe të rreme rreth burrave, grave, kombësive të ndryshme etj.  
Nxënësit, duke reaguar për çdo pohim, shkojnë në njërin cep apo në tjetrin, në përputhje me çka besojnë që është e vërtetë apo e rreme.  
Nxënësit që nuk kanë asnjë mendim të qëndrojnë në mes.
2. Mësuesi i fton nxënësit të shpjegojnë zgjedhjet e tyre.  
Mësuesi jep përgjigjen e saktë. Është thelbësore që ky hap të mos harrohet.
3. Nxënësit reagojnë ndaj informacionit të mësuesit. Ky i nxit ata të shpjegojnë se si i kanë perceptuar të tjerët, veçanërisht, në qoftë se këto perceptime kanë dalë të pasakta.

### Shtojcë

Nxënësit analizojnë mënyrën në të cilën media trajton çështjet që kanë të bëjnë me pakicat, gjininë, dhunën etj. Ata identifikojnë shembujt e stereotipave, paragjyqimeve, cektësisë apo gjerësinë dhe të gazetarisë hetuese. Nxënësit përpiqen të ndreqin informacionin që besojnë se është i gabuar ose i paplotë.

## Ushtrimi 4.4. – Mbresat e para

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit janë në gjendje të identifikojnë stereotipat dhe bëhen të vetëdijshëm rreth larmisë së përshtypjeve dhe perceptimeve që njerëzit kanë për njëri-tjetrin.
<b>Burimet</b>	Nxënësit praktikojnë të dëgjuarit aktiv dhe mësojnë respektin ndaj të tjerëve.  Fotografitë e njerëzve që mund të shkaktojnë reagime të ndryshme te nxënësit janë ngjitur në një tabak të madh letre (mësuesi duhet të zgjedhë karaktere shumë të ndryshme duke pasur si kriter: moshë, kulturën, grupin etnik etj.).

### Procedura

1. Nxënësit formojnë një rreth. Mësuesi i jep çdo nxënësi një fletë letre.
2. Mësuesi kërkon çdo nxënësit të shohin fotografinë e tij:
  1. «Unë shikoj...»
  2. «Unë mendoj se...»
  3. «Unë ndihem...»
3. Nxënësit shkruajnë përshtypjen e tyre të parë në fund të faqes. Atë e palosin në mënyrë që të fshehin tekstin dhe fletën e kalojnë te personi në të majtë të tyre.
4. Kjo vazhdon derisa të gjitha fletët përshkojnë shpejt rrethin e nxënësve.
5. Nxënësit krahasojnë përshtypjet e tyre të para:
  - Si ndryshonin apo ishin të ngjashme përshtypjet tuaja të para?
  - Çfarë të tërhoqi te përshtypja juaj e parë?
  - Cilat aspekte nuk ju tërhoqën vëmendjen dhe pse?
  - Çfarë ju tregoi kjo veprimtari për veten tuaj?

### Zgjerim

Ky ushtrim mund të bëhet me një numër shumë të vogël fotografish ose edhe vetëm me një të tillë, ose me një video etnografike. Çdo nxënësi mund t'i kërkohet të shkruajë përshtypjet në një copë letër.

Mësuesi mund të japë informacion për kulturat e tjera: ushqimi, muzika, përbërja familjare etj.

## Ushtrimi 4.5. – Të gjithë ne kemi paragjykime

<b>Objektivat mësimore</b>	Në këtë ushtrim, nxënësit vënë në dyshim stereotipat dhe paragjykimet për njerëzit e tjerë dhe ndaj pakicave. Ato zbulojnë perceptimet për pakicat e ndryshme. Nxënësit ndërgjegjësohen për kufijtë e durimit të tyre dhe për sistemin e vlerave të tyre të debatueshme. Nxënësit stërviten për të zhvilluar aftësitë e tyre të dëgjuarit aktiv në kërkim të arritjes së marrëveshjes.
<b>Burimet</b>	Çdo nxënës ka nga një kopje të fletës së veprimtarisë (skenar).

### Procedura

1. Çdo nxënës merr një kopje të skenarit dhe e lexon në heshtje.
2. Çdo nxënës zgjedh tre shokë/shoqe me të cilët ai do të parapëlqente të udhëtonte dhe tre të tjerë që nuk do të pranonin të udhëtonin me të.
3. Nxënësit formojnë grupe me nga katër veta.
  - Ata krahasojnë zgjedhjet vetjake dhe arsyet përkatëse për zgjedhjet e tyre.
  - Ata përpiqen të merren vesh për një listë me tri parapëlqime dhe tri mospëlqime.
  - Ata zgjedhin zëdhënësin e grupit të tyre.
4. Çdo grup i paraqet klasës listën e shokëve të parapëlqyer dhe të përjashtuar, duke dhënë arsyet e zgjedhjeve të tyre.
5. Mësuesi nxit një diskutim të lirë rreth përvojave, për shembull:
  - Cilët kanë qenë faktorët kryesorë përcaktues?
  - Përse grupi nuk është marrë vesh për listën e parapëlqimeve?
  - Cili nga stereotipat është përfshirë në listën e udhëtarëve?
  - Prej nga vijnë këto imazhe?
  - Si do të ndiheshit nëse askush nuk do të donte, për shembull, të ndante kabinën e trenit me ju?

### Zgjerim

Lista mund të përshtatet në varësi të grup-moshës dhe të formimit shoqëror të nxënësve, por ajo duhet të përfshijë ata njerëz që përfaqësojnë pakicat që dallohen qartësisht, qysh me shikimin e parë dhe të tjerët që nuk janë si këta.

Pakicat dhe diskriminimi mund të studiohen edhe nëpërmjet historisë ose letërsisë.

### Materialet

(shih faqen që vijon)



## Skenari

Ju keni filluar një udhëtim të gjatë me tren që do të zgjatë për disa ditë me radhë. Në kabinë, do të flini bashkë me tre të tjerë.

Me cilin nga udhëtarët e mëposhtëm do të parapëlqenit të flinit në kabinë?

Me cilin nga udhëtarët nuk do të donit të flinit në kabinë?

- një bankier zviceran, i dhjamosur
- një paraqitës italian i programit diskografik, që merr drogë
- një afrikan, që shet artikuj ekzotikë
- një cigan, që sapo ka dalë nga burgu
- një këngëtar gjerman rroku, që është i dhënë pas femrave
- një student i huaj homoseksual
- një grua e re rumune, që mban një fëmijë të vogël
- një djalë i ri anglez kokërruar, i dehur
- një prostitutë me HIV pozitiv
- një refugjat, shumë i varfër
- një ushtar i huaj, i armatosur
- një grua e re që vetëm flet frëngjisht.

## Ushtrimi 4.6. Të gjithë jemi të barabartë, por disa ca më shumë

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit identifikojnë dhe analizojnë arsyet e nxitjet që çojnë në diskriminimin e të tjerëve. Ky ushtrim përqendrohet në ndikimin e faktorëve social-ekonomikë në shanset e suksesit në shoqëri.
<b>Burimet</b>	Tabakë të mëdhenj e të trashë letre dhe stilolapsa shënjes.

### Procedura

1. Mësuesi i ndan nxënësit në grupe, jo më të madha se gjashtë veta. Grupet duhet të përbëhen, patjetër, nga një numër çift anëtarësh. Secili grup merr një fletë letre dhe një shënjes.
2. Mësuesi u kërkon gjysmës së grupeve të vizatojnë karikaturën e atij që ka korrur sukses në shoqëri, ndërsa, gjysmës tjetër, karikaturën e atij që ka dështuar në shoqëri.
3. Mësuesi kërkon që nxënësit të shënojnë në listë veçoritë e shembullit të tyre: nivelin social-ekonomik, profesionin, gjininë, grupin etnik, veprimtaritë që ai kryen në kohën e lirë, zgjedhjen e veshjeve, botëkuptimin e plotë, mënyrën e jetesës, llojin e strehimit, zakonet e konsumit.
4. Ai u kërkon grupeve të shkëmbejnë me njëri-tjetrin vizatimet e tyre dhe t'i interpretojnë ato.
5. Më pas, vizatimet varen në mur. Nga secili grup kërkohet të interpretojë, para gjithë klasës, vizatimin që kanë marrë.
6. «Piktorët» komentojnë qëllimet e tyre. Nxënësit, duke kumtuar idetë që qëndrojnë prapa vizatimeve dhe ndikimet që ato lënë te shikuesit, pritët t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:
  - Cilat janë veçoritë kryesore të suksesit?
  - Cilat janë veçoritë kryesore të dështimit?
  - Cilat janë faktorët që bëjnë dallimin mes «fituesve» dhe «humbësve»?
  - A përfaqësohen njerëzit nga grupe të caktuara?
  - A kanë të gjithë njerëzit të njëjtat gjasa për të pasur sukses, pavarësisht nga përkatësia e tyre shoqërore?

### Zgjerim

Cilat janë arsyet e diskriminimit dhe të përjashtimit të njerëzve që janë të ndryshëm për shkak të kulturës, prejardhjes, qëndrimit seksual, gjuhës së tyre etj?

Cilat janë arsyet e pabarazisë mes njerëzve? A është e mundur dhe e dëshirueshme barazia, apo jo?

## Ushtrimi 4.7. – Turistët

<b>Objektivat mësimore</b>	Kjo lojë që bën t'i kuptosh më mirë të tjerët simulon përplasjen midis kulturave dhe u lejon nxënësve të vëzhgojnë stereotipat që ata paraqitin në lojën në fjalë. Kjo do t'i ndihmojë ata të bëhen të vetëdijshëm për mosmarrëveshjet e mundshme në të tilla situata. Ushtrimi i bën nxënësit të ndryshojnë pikëpamjet e tyre, duke e «vënë veten në vendin e të tjerëve». Nxënësit zhvillojnë aftësitë e tyre komunikuese.
<b>Burimet</b>	Një copë letër apo karton, shënjuese me ngjyra; nëse është e mundur, disa pajisje turistike, p.sh. një aparat fotografik.

### Procedura

#### Shënim mbi metodën

Më e mira e të mirave do të ishte po të punohej me dy klasa të ndryshme, ku secila për drejtues të kishte mësuesin e vet. Roli i dy mësuesve është që nxënësve t'u kujtojnë udhëzimet dhe tiparet dalluese të grupeve të tyre përkatëse: «turistët» dhe «të vegjlit».

1. Dy grupet takohen në klasat e tyre përkatëse. Ata kanë 15 minuta për të krijuar kontekstin në të cilin do të kryhet puna dhe do të përgatiten për rolet e tyre.  
Turistët hedhin me shkrim të dhëna për vendin e tyre, u ngjallen shpresat për udhëtimin dhe bëjnë gati pajisjet që do t'u duhen gjatë udhëtimit, p.sh., aparat fotografik, celularët, valutë e huaj. Nëse këto nuk sigurohen aty për aty, atëherë ato t'i simbolizojnë me vizatime. Turistët «X» përkufizojnë kulturën e tyre: përbërja familjare, ekonomia, zejet që ushtrojnë, veshja dhe strehimi. Turistët «X», brenda mundësive, duhet të jenë sa më primitivë. Ata e emërtojnë vetë veten e tyre.  
Elementet kulturore duhet të jenë homogjene. Edhe këto mund të simbolizohen me vizatime.
2. Kjo veprimtari mund të bëhet në kohën e mëposhtme në klasë.  
Dy «turistët», ndërsa bëjnë pazar për suvenire dhe bëjnë fotografi, takohen me anëtarët e e grupit «X».  
Ata kthehen në grup dhe tregojnë përvojën e tyre. Përshtatëse se çfarë u ka rënë në sy në lidhje me kulturën e çuditshme të grupit «X».  
Anëtarët e grupit «X» ndajnë përshtypjet e tyre për takimin e parë me turistët, duke shprehur mendimin rreth qëndrimit të turistëve.
3. Turistët mësojnë vendin e grupit «X», anëtarët e të cilëve sikur nuk ua ka qejfi të ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës.
4. Të dyja grupet takohen për të dhënë mendime:
  - Si ndihen turistët?
  - Po ata të grupit «X»?
  - Çfarë mendojnë turistët për ata të grupit «X»?
  - Çfarë mendojnë anëtarët e grupit «X» për turistët?
  - Turistët shpjegojnë çka u duket e vështirë në sjelljen e anëtarëve të grupit «X».
  - Anëtarët e grupit «X» sqarojnë çka u duket e vështirë në lidhje me sjelljen e turistëve.
  - Sipas anëtarëve të grupit «X», ç'duhej të bënin turistët në mënyrë që ta bënin më të lehtë takimin?
  - Sipas anëtarëve të grupit «X», ç'duhej të bënin turistët me qëllim që të krijonin më pak shqetësime?
  - Në rast se do të detyroheshit të shkonit përsëri në vendin e anëtarëve të grupit «X», çfarë duhet të dini ose të bëni që të silleni siç duhet?

## **Zgjerim**

Nxënësit intervistojnë anëtarët e bashkësisë së tyre që kanë vizituar vende të tjera ose i ftojnë ata në klasë për të ndarë përvojën e tyre me njerëz që kanë një prejardhje të ndryshme kulturore.

## **Variacion**

Nxënësit imagjinojnë shoqërinë ideale dhe tregojnë ndryshime të rëndësishme në krahasim me kulturën e tyre.

#### Ushtrimi 4.8. – Globingo: «Qenia njerëzore është pjesë e gjithë botës».

<b>Objektivat mësimore</b>	Qëllimi i kësaj loje është që të tregojë se një qenie njerëzore është pjesë e gjithë botës.
<b>Burimet</b>	Një fletë e ndarë në kuti bingoje për çdo nxënës. Fleta me pyetje. Pyetje për diskutim në grup.

#### Procedura

1. Nxënësit plotësojnë kutitë në përputhje me pyetjet e ngritura. Çdo kuti ka dy vija: një për emrin dhe tjetrën për vendin. Për çdo kuti ata duhet të përpiqen të gjejnë emrin e njërit prej shokëve të klasës së tyre, si dhe emrin e vendit që i përshtatet. Pyetjet që mund të drejtohen janë të shumëllojshme. Zakonisht, duhet të përdorni shkronjat nga A deri te L-ja, por mund të shtoni edhe të tjera, edhe pse nxënësve u lejohej të përdorin vetëm një herë emrin e një shoku të klasës. Përndryshe, atyre u duhet t'i vënë kryq vetëm një kutie dhe s'mund të bëjnë «bingo» në atë rresht.
2. Pas lojës, mund të bëhet diskutimi në grup. Nxënësit do të kuptojnë se emigrimi është i zakonshëm jo vetëm për çdo familje, por edhe për kombin. Ata do të bashkëbisedojnë për situata botërore dhe botën si rrjet.

#### Materiale për mësuesit

##### Pyetjet: gjeni dikë në dhomë që...

- ka udhëtuar në një vend të huaj;
- ka zënë një mik nga një vend tjetër, nëpërmjet letërkëmbimit;
- po mëson një gjuhë të huaj;
- ka një të afërm në një dhé të huaj;
- zbavitet me muzikën e një vendi të huaj;
- ka ndihmuar një vizitor nga një vend i huaj;
- i pëlqen ushqimi nga një vend i huaj;
- ka një makinë të prodhuar në një vend të huaj;
- jeton në një shtëpi, ku gjuhët që fliten janë më shumë se një;
- ka një të afërm që ka lindur në një vend tjetër;
- kohët e fundit në gazetë ka lexuar një histori për një vend tjetër;
- kohët e fundit ka folur me dikë që ka jetuar në një vend tjetër;
- kohët e fundit në televizion ka mësuar diçka në lidhje me një vend tjetër.


##### Pyetje për diskutim në grup

1. Çfarë keni mësuar për njëri-tjetrin në këtë proces?
2. Cila ka qenë gjëja më e çuditshme që keni mësuar për bashkënxënësit e klasës tuaj?
3. Çfarë ju tregoi loja për botën tonë?

**Materiale për nxënës: Fletët e bingos**

A Emri _____ Vendi _____	B Emri _____ Vendi _____	C Emri _____ Vendi _____	D Emri _____ Vendi _____
E Emri _____ Vendi _____	F Emri _____ Vendi _____	G Emri _____ Vendi _____	H Emri _____ Vendi _____
I Emri _____ Vendi _____	J Emri _____ Vendi _____	K Emri _____ Vendi _____	L Emri _____ Vendi _____

## Kreu 5 – Funkcionimi i drejtësisë



### Hyrje

Figura tregon një djalë dhe një vajzë në një shilarës. Pika ku mbështetet shilarësi s'është në mes, duke i siguruar vajzës krah më të gjatë se të djalit. Pra, vajza mbizotëron lojën dhe, siç duket, asaj i pëlqen një gjë e tillë. Djali, me fytyrë prej të pakënaquri, po përpiket fort të zbresë, mirëpo përpjekjet e tij janë të kota. Shpesh situata të tilla çojnë në grindje dhe përplasje. Pika mbështetëse në mes përfaqëson simbolin e një paragrafi që ka të bëjë me ligjin.

Figura mund të lexohet në mënyra të ndryshme dhe kjo bën që të shtrohen pyetje interesante. Mundësitë e vajzës dhe të djalit në këtë situatë janë të pabarabarta, gjë që trajton çështjen e barazisë gjinore. Çuditërisht, «krahun më të gjatë» të boshtit e ka vajza. Ndoshta ajo po mashtron, gjë që do të thotë se ajo e ka shkelur ligjin ose po përfiton nga një epërsi e siguruar me ligj për të zhdëmtuar diskriminimin ndaj grave dhe vajzave në të kaluarën. Por, a është e ndershme kjo lojë? A është barazia gjithmonë e drejtë? Të drejtat e kujt mbrohen me ligj. A shkelen të drejtat e ndokujt dhe nga kush?

Simboli i paragrafit shpalos një këndvështrim tjetër. Kush i ka vendosur rregullat e kësaj loje? Simboli zyrtar i ligjit ka lidhje me shtetin dhe sundimin e ligjit. Shteti mund të përbëhet nga institucionet që ndajnë pushtetin dhe kontrollojnë njëra-tjetrën përmes një sistemi balance dhe kontrolli: parlamenti, qeveria dhe gjykatat. Ai mund të drejtohet nga një autokrat mirëdashës apo despotik. Ligjet janë mjaft të rëndësishme, meqë ato i shndërrojnë të drejtat e njeriut në të drejta civile për qytetarët e një shteti-komb. Prandaj, ligjet mbrojnë të drejtat e njeriut, kur këto shkelen. Megjithatë, siç tregohet në figurë, të drejtat e njeriut mund të shkelen nga bashkëqytetarët, madje edhe nga një ligj jo i drejtë.

Nga ana tjetër, ligji duhet të vendosë drejtpeshimin mes të drejtave të qytetarëve si individë dhe të përcaktojë kufijtë e të drejtave të njeriut si individ për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Ushtrimet në këtë kapitull merren me çështjet e barazisë dhe drejtësisë. Nxënësit do të kuptojnë se drejtësia është vendimtare për paqen dhe sigurinë në shoqëri.

## Ushtrimi 5.1. – Kjo është e padrejtë

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit vetëdijesohen për konceptet e tyre për drejtësinë dhe padrejtësinë.
<b>Burimet</b>	Studime shoqërore dhe gjuhë.

### Procedura

Nxënësit punojnë në çifte.

1. Mësuesi i kërkon çdo çifti të zgjedhë nga një foto.
2. Mësuesi kërkon nga nxënësit të përshkruajnë gjendjen siç e kuptojnë:
  - «Mund të shoh...» (përshkrimin faktik)
  - «Unë ndihem...» (reagim emocional)
  - «Kjo më bën të mendoj për...» (shoqërizim, ide)Pastaj, mësuesi u kërkon atyre të renditin fotot, duke përdorur tri kategori:
  - Fotografitë tregojnë një situatë që është e drejtë dhe e paanshme.
  - Fotografitë tregojnë të kundërtën, d.m.th., një shembull të padrejtësisë.
  - Nxënësit nuk janë të sigurt si t'i grupojnë fotografitë.
3. Palët formojnë grupe me nga katër nxënës. Çdo palë i shpjegon palës tjetër pikturën e vet dhe përpiqet t'i bindë ata për vendimin. Pastaj pikturat bashkë me komentet e grupeve. paraqiten në klasë. Çdo nxënës duhet të ketë kohë për të studiuar ekspozitën.
4. Sesiioni plenar:
  - Cilat situata përshkruhen si të drejta – ose si të padrejta?
  - Përse nuk qe e lehtë të merrej vendim rreth disa situata të përshkruara?
  - Cilat rrethana shkaktojnë padrejtësi?
  - Si mund të ndryshohen këto situata të padrejta?

### Zgjerim

Nxënësit formojnë disa grupe. Çdo grup zgjedh një shembull padrejtësie dhe trajton pyetjen e fundit: Si mund të mposhtet kjo formë e padrejtësisë?

Së pari, ata mund të identifikojnë të drejtat e njeriut që janë shkelur në rastin në fjalë. Së dyti, mund të kërkojnë të gjejnë mënyra të ndryshme për të mbrojtur dhe zbatuar të drejtat e njeriut.



## Ushtrimi 5.2. – Përrjashtime

<b>Objektivi mësimor</b> <b>Burimet</b>	Nxënësit njihen me temën e diskriminimit. Numra të ndryshëm të afisheve me ngjyra, dhe një afishe e bardhë.
--	--

### Procedura

Nxënësit punojnë në çifte.

1. Mësuesi ngjit një afishe në ballin e secilit nxënës. Këta nuk duhet të dinë se ç'ngjyrë kanë ato. Për këtë arsye nxënësit duhet të mbyllin sytë kur u ngjiten afisheet.
2. Nxënësit hapin sytë. Tani çdonjëri prej tyre duhet të gjejë anëtarët e tjerë të grupit të tij a të saj, me grupet që e përftuara përfundimisht nga ngjyrat e afisheve të tyre.
3. Reagime dhe përsiatje plenare. Këshillohen pyetje e të dhëna si ato që vijojnë:
  - Si u ndjetë kur ndeshët personin e parë që kishte afishe të njëjtë me tuajën?
  - Si ndihej personi i pajisur me afishe të bardhë?
  - A u përpoqët të ndihmonit njëri-tjetrin në grupin tuaj?
  - Si mund të bashkohet personi me afishe të bardhë?
4. Ushtrimi mund të shërbejë për t'i njohur nxënësit me marrëdhënien mes grupeve të shumicës dhe atyre të pakicave në shoqëri:
  - Kush mund të jenë përrjashtimet, të përrjashtuarit, në shoqëri?
  - A mund të jetë përrjashtimi zgjedhje vetjake?

### Zgjerim

Ushtrimi mund të vazhdohet duke i sjellë kështu dobi grupit. Nxënësit mund të përfshihen më shumë, por kjo gjë mund të krijojë stres dhe armiqësi. Prandaj, mësuesi duhet ta njohë mirë klasën dhe duhet të jetë i përgatitur për të reaguar si duhet.

## Ushtrimi 5.3. – Të formojmë figurën

<b>Objektivat mësimore</b>	Loja simulon përvojën rreth një trajtimi të padrejtë. Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për reagimet e tyre ndaj trajtimit të padrejtë, që mbështetet mbi parimet etike të drejtësisë. Drejtësia është kategori themelore e të drejtave të njeriut. Nxënësit kuptojnë rëndësinë e solidaritetit dhe bashkëpunimit në mposhtjen e padrejtësive.
<b>Burimet</b>	Zarfat me lojëra me bashkim figurash ose pikturash të prera në pjesë të vogla.

### Procedura

1. Përgatitja: duhet të ketë nga një gjëzë për çdo grup të përbërë nga tre ose katër veta. Mësuesit mund të përdorin lojëra të thjeshta me bashkim figurash ose këto mund t'i përgatitin duke prerë fotografi ((p.sh., kartolina ose reklama) në disa pjesë. Çdo lojë e tillë duhet të vihet në një zarf. E mira do të ishte që një kopje e fotografisë të ngjitet brenda zarfit. Një pjesë të figurave mësuesi e nxjerr jashtë dhe disa prej tyre i këmben me lojëra të tjera me bashkim figurash. Disa lojëra të tilla duhet të jenë të plota.
2. Nxënësit formojnë grupe me tre-katër anëtarë. Çdo anëtar të skuadrës mësuesi i cakton një detyrë të veçantë:
  - një nxënës që është përgjegjës për respektimin e kohës dhe burimeve;
  - një arbitër që parandalon mosmarrëveshjet dhe sigurohet që udhëzimet të zbatohen si duhet;
  - një nxënës që ka kopjen e lojës me bashkim figurash të përfunduar;
  - një nxënës që kryen detyrën e ngarkuar.Mësuesi i shpërndan nga një zarf secilit grup, duke i caktuar detyrën që gjëgëzën ta zgjidhin brenda një afati kohor (të ngushtë). Pas pak, nxënësit do të zbulojnë nëse e kanë zgjidhur gjëzën, por nëse jo, atëherë ata mund të sigurojnë mbështetje nga grupet e tjera.
3. Loja përcakton qartë fituesit dhe humbësit. Në varësi të grupmohës dhe reagimit të nxënësve, pyetje e mëposhtme mund të shërbejnë për të artikuluar dhe vlerësuar përvojën e diskriminimit pozitiv ose negativ:
  - Si u ndjetë kur e kuptuat se grupet kishin materiale të ndryshme?
  - Si do të ndiheshit sikur të ishit në një grup tjetër?
  - Si u ndjetë, si pjesë e grupit, që kishit shumë pak ose shumë material?
  - Çfarë lloj sjelljeje e ndihmoi ose e pengoi suksesin e grupit?

### Zgjerim

Nxënësit nxiten të diskutojnë situata të vërteta, në të cilat njerëzit nuk kanë mundësi të barabarta në burimet e rëndësishme (p.sh., kohë të lirë, punë, të holla, pushtet).

## Ushtrimi 5.4. – Roli i ligjit

<b>Objektivat mësimore</b>	Filozofët e lashtë kanë përdorur vlera të ndryshme në përcaktimin e qëllimit të ligjit. Zgjedhjet e vlerave të ndryshme kanë lidhje me sistemet politike dhe shoqërore të ndryshme. Teoria siguron kuadrin për përsiatjen mbi përvojën e përditshme, ku zgjedhjet e vlerave tona udhëhiqen po nga interesat tona. Nxënësit janë të nxitur të bëjnë zgjedhje të kujdesshme në lidhje me vlerat brenda kornizës së të drejtave të njeriut, t'ia nënshtrojnë krahasimit dhe diskutimit dhe t'i zbatojnë në jetën e përditshme ato.
<b>Burimet</b>	Në një fletë të madhe letre shkruhen konceptet e ndryshme të rolit të ligjit dhe ato paraqiten në mur (shih M 1 te pjesa e materialeve).

### Procedura

1. Nxënësit formojnë grupe me nga tre ose katër veta. Atyre u jepen fletët e punës, me një listë rregullash të sjelljes (shih M 2 te pjesa e materialeve).
2. Secili grup duhet të bëjë lidhjen e rregullave të sjelljes me konceptin themelor të ligjit (10 minuta).
3. Mësuesi kontrollon rezultatet e tyre.
4. Nxënësit zgjedhin konceptin për të cilin janë më shumë të bindur.
5. Nxënësit zgjedhin konceptin për të cilin janë më pak të bindur.

### Zgjerim

Reflektimi në klasë:

- A përkojnë rregullat që i zbatoni në jetë me zgjedhjen tuaj?
- A i njihni rregullat që kanë të bëjnë me zgjedhjet që i keni hedhur poshtë? I keni kundërshtuar ato? Pse? Çfarë keni bërë?

Reflektim me shkrim:

- Me cilin koncept të ligjit përkushtoheni më shumë dhe pse?
- Bëni të ditur pesë rregulla të jetës së përditshme që iu përmbaheni.

### Materialet

(shih faqen në vijim)

### **M 1: Konceptet themelore të ligjit**

1. Qëllimi i ligjit është t'ua ndalojë personave të nëpërkëmbin të drejtat e njerëzve të tjerë (Aristoteli).
2. Qëllimi i ligjit është që t'i japë secilit atë që meriton (Aristoteli).
3. Qëllimi i ligjit është krijimi i një shoqërie të përsosur (Platoni).
4. Ligji shërben për të parandaluar dëmin që u bëhet individëve nga padrejtësia (Glaukon).
5. Ligji duhet të shërbejë për të mbrojtur interesat e atyre që qeverisin (Trasimakus).
6. Roli i ligjit është të ruajë paqen shoqërore duke siguruar mirëqenien e të gjithëve dhe për të detyruar zbatimin e asaj që është e dobishme për shoqërinë (Protagora).
7. Qëllimi i ligjit është mbrojtja e më të dobëtëve.

### **M 2: Rregullat**

1. Njerëzit që kanë keqtrajtuar fëmijët e tyre do të burgosen.
2. Shteti u siguron të papunëve të ardhura që u lejojnë të mbijetojnë.
3. Përparësi për punë do të kenë studentët që kanë nota të mira.
4. Të gjithë punëtorët duhet të kontribuojnë diçka nga të ardhurat e tyre për të plotësuar nevojat e të papunëve.
5. Çdo veprim i kryer nga personi që i shkakton një dëm personit tjetër, e detyron të parin ta dëmshpërblejë atë për atë veprim.
6. Mësuesit do të sigurohen që nxënësit të dinë se ligjet e shoqërisë tonë, duke qenë ligjet më të mira, janë të padhunueshme.
7. Të gjitha ata persona që shfaqin kundërshtimin ndaj organizimit të shoqërisë do të dërgohen në një qendër riedukimi.
8. Lejohen vetëm veprimtaritë e lejuara nga shteti në emër të mirëqenies së të gjithëve.
9. Vetëm tatimpaguesit kanë të drejtën e votës.
10. Të gjithë të rinjtë duhet t'u përkasin organizatave shtetërore në mënyrë që të merren me punë të dobishme.
11. Shoqëritë tregtare duhet të vendosin filtra kundër ndotjes tek oxhakët.
12. Askujt nuk i lejohet të përhapë ide që nuk pranohen si të vlefshme nga qeveria.
13. Shteti ka të drejtë të shpronësojë, nëse është e nevojshme për interesin e përbashkët.
14. Drejtuesit e shoqërive tregtare gëzojnë të drejtën të organizojnë shërbimet private të sigurisë.
15. Nuk lejohet hyrja në shtëpinë e dikujt tjetër, pa lejen e tij ose të saj.

## Ushtrimi 5.5. – Perspektivat për drejtësi

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit kuptojnë se mund të ketë perspektiva të ndryshme në çështjet e drejtësisë. Nxënësit marrin një kuptim të qartë të drejtpeshimit mes të drejtave dhe detyrimeve.
<b>Burimet</b>	Grupe me fletë pune që përmbajnë perspektivën A ose B.

### Procedura

1. Zgjidhet një nga të drejtat që do të shqyrtohet.
2. Klasa ndahet në grupe me nga katër apo gjashtë veta.  
Gjysma e secilit grup merr fletën A, gjysma tjetër fletën B.  
Çdo nëngrup përgatit sa më shumë argumente të mundë, në mbrojtje të deklaratës së paraqitur në fletën e tyre.
3. Grupet bashkohen. Anëtarët e nëngrupit A i paraqitin pikëpamjen e tyre anëtarëve të nëngrupit B, të cilët duhet të dëgjojnë me vëmendje dhe të marrin shënime.  
Pastaj radhën e ka nëngrupi B.  
Paraqitja e argumenteve mund të pasohet nga një kohë e caktuar, gjatë së cilës anëtarët e nëngrupeve të ndryshme i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit.
4. Nëngrupet A dhe B këmbajnë rolet. Ata nuk duhet informuar paraprakisht për këtë pjesë të ushtrimit.  
A tyre u jepen disa minuta për të rishqyrtuar argumentet e tyre.
5. Grupet përpiqen të miratojnë një qëndrim të përbashkët me shkrim për problemin që po diskutohet.
6. Pyetje për t'u marrë parasysh:
  - Me çfarë vështirësish jeni përballur tek përpiqeshit të arrinit një qëndrim të përbashkët?
  - Këmbimi i roleve jua bëri më të lehtë apo më të vështirë arritjen e një qëndrimi të përbashkët?

### Zgjerim

Mësuesi (ose nxënësit) kujtojnë raste ku liria e shprehjes (ose puna që kryejnë fëmijët) është një çështje kundërshtuese

- Si mund të baraspeshohen të drejtat dhe detyrat?
- A ka detyra – ose të drejta – që vënë kufizime mbi disa të drejta të tjera?

Për studimin e rasteve në fjalë duhet të përdoret informacioni i dhënë në media. Hulumtimi mund të zgjerohet për të përfshirë të drejtat e tjera të njeriut, p.sh. lirinë e lëvizjes ose të drejtën e pronës.

### Materialet

(shih faqen në vijim)

### **Këndvështrimi A: Liria e shprehjes**

Në një shoqëri të paanshme, liria e shprehjes është një e drejtë themelore e njeriut që nuk duhet kufizuar. Shqyrtoni pikat e mëposhtme:

- pasojat negative të censurës;
- nënkuptimet politike të kufizimit dhe disidencës së saj;
- rrethanat në të cilat vendet e tjera e kufizojnë atë;
- rëndësia që liria e shprehjes ka për demokracinë;
- çdo problem tjetër që ka lidhje me të

### **Këndvështrimi A: Puna e fëmijëve**

Ligjet kundër punës së fëmijëve duhet të zbatohen me rreptësi në mënyrë që të mbrohet e drejta që kanë fëmijët për të luajtur, mësuar dhe për t'u bërë rritur të shëndetshëm.

Shqyrtoni pikat e mëposhtme:

- mungesa e arsimit që vjen kur fëmijët janë të detyruar të punojnë;
- fakti që fëmijët shpesh punojnë në kushte jo të shëndetshme;
- shpesh puna e fëmijëve shfrytëzohet ngaqë ata nuk organizohen në protesta kundër trajtimit të padrejtë;
- çdo problem tjetër i rëndësishëm.

### **Këndvështrimi B: Liria e shprehjes**

Nganjëherë, në një shoqëri të drejtë, lind nevoja për të kufizuar lirinë e shprehjes në mënyrë që të mbrohen të drejtat e njerëzve. Shqyrtoni pikat e mëposhtme:


- pasojat e vërejtjeve raciste për pakicat;
- mënyra e të folurit që mund të përdoret për të nxitur dhunën;
- mungesa e kufizimit, në disa vende, të lirisë së shprehjes çon në shkeljen të drejtave;
- nevoja për të nxitur jo vetëm detyrat, por dhe të drejtat;
- çdo problem tjetër i rëndësishëm.

### **Këndvështrimi B: Puna e fëmijëve**

Fëmijët, për të ndihmuar familjet që të mbijetojnë në rrethana të vështira ekonomike, dhe për t'i ndihmuar ata që të luajnë një rol më aktiv në shoqëri, duhet të jenë në gjendje të punojnë e ndihmojnë familjet e tyre. Shqyrtoni pikat e mëposhtme:

- fakti që punësimi, në disa shoqëri, është i rrallë, fëmijët mund të jenë burimi i vetëm i të ardhurave për familjen;
- fakti që, në shumë shoqëri, fëmijët tradicionalisht kanë punuar më shumë se të rriturit;
- mendimi që pengimi i fëmijëve për të mos u marrë me punë prodhuese shpie në veçim të pavlefshëm nga bota e të rriturve;
- fakti që puna mund të jetë një përvojë që i formon fëmijët;
- çdo problem tjetër që ka lidhje me të.

## Kreu 6 – Të kuptuarit e filozofisë politike



### Hyrje

Në figurë janë paraqitur një djalë e një vajzë që rrinë përballë njëri-tjetrit. Ata po i tregojnë shoqi-shoqit nga një kub me simbole që paraqitin filozofinë politike. Rëndësi ka që ata po i buzëqeshin njëri-tjetrit, meqenëse simbolet ndryshojnë dhe shprehin kundërshti dhe mosmarrëveshje. Ia vlen të zbulosh domethënien e simboleve, për aq sa është e mundur. Djali tregon simbolin e «ndalimit të bombës», duke i rrëfyer për pacifizmin. Pentagrami mund të përfaqësojë pikëpamjen socialiste, por edhe këndvështrimin tërësor të njerëzimit në gjithësi. Vijat dredha-dredha mund të përfaqësojnë ujin, si simbol për mbrojtjen e mjedisit, por kuptimi mund të jetë edhe krejtësisht i ndryshëm. Vajza tregon simbolin A të anarkizmit. Simboli i gjinisë femërore mund të përfaqësojë këndvështrim feminist. Lulja mund të paraqitë mbrojtjen e mjedisit, a të paqes, por këtij simboli vajza mund t'i ketë dhënë edhe një kuptim të ndryshëm. Të rinjtë po përdorin të drejtat e njeriut: lirinë e mendimit, të shprehjes dhe të barazisë. Nuk ka asnjë pushtet të vendosë se çfarë është e drejtë dhe çfarë e gabuar.

Figura mbart një mesazh interesant dhe çuditërisht të ndërlikuar. Ne ndërthurim simbolet dhe konceptet në filozofinë politike për të shprehur idetë dhe pikëpamjet tona, por ato mund të jenë të dyvlershme ose mashtruese. Prandaj, duhet t'i shpjegojmë zgjedhjet tona njëri-tjetrit dhe t'i dëgjojmë me kujdes. Ka shumë pika për të cilat mund dhe s'mund të jemi në të njëjtën mendje me ta. Gjashtë simbole mjaftojnë për të na dhënë një ide për një shoqëri pluraliste të hapur. Njëri-tjetrin duhet ta trajtojmë me respekt; vetëm atëherë mund të kemi në dorë një argument të fortë, që nuk 'dëmton asnjë dhe u sjell dobi të gjithëve.

Edukimi për qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut (EQD/EDNJ) përmban dy dimensione. I pari ka lidhje me *përmbajtjen*. Të kuptuarit e filozofisë politike ka rëndësi tek EQD/EDNJ, meqë na pajis me ndjesinë e drejtimit dhe të vlerave kur gjykojmë çështje dhe ndërmarrin veprime. Gjithashtu, i kuptojmë më mirë të tjerët.

Dimensioni i dytë i EQD/EDNJ ka të bëjë me *kulturën* e kundërshtimit të qytetëruar – mundësisht, të argumentojmë duke buzëqeshur. Në shkollë duhet të mësohet një kulturë e tillë kundërshtimi, me anë të përvojës dhe reflektimit. Kjo mund të fillojë në një moshë shumë të re dhe, shumë, varet nga shembulli që lënë mësuesit dhe drejtorët. Mësuesi i EQD/EDNJ duhet të marrë masat të shmangë dy kurthe. Njëra është paanshmëria politike. Nuk është e detyra e mësuesit t'u mësojë nxënësve ndonjë doktrinë politike të parapëlqyer, dhe as t'i shtrëngojë të pranojnë pikëpamjet e tij. E dyta është mospërfillja në heshtje, që është një formë tinëzare e shtypjes. Nxënësit duhet të mësohen të presin, t'i kushtojnë vëmendje të ndërsjellë edhe të reagojnë. Mësuesi duhet t'i nxitë nxënësit të shpjegojnë zgjedhjet e tyre, në mënyrë që të tjerët të mund t'i kuptojnë ato, por ata nuk duhen detyruar t'i përligjin ato.

Ushtrimet mund të përshtaten për grupmoshat e ndryshme dhe mund të përdoren nga fillorja deri në të mesmen.

## Ushtrimi 6.1. – Konceptet themelore të mendimit politik

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit kuptojnë vlerat që, pa dyshim, drejtojnë argumentin dhe debatin politik dhe se disa nga këto vlera mbështetin të drejtat e njeriut, kurse të tjerat janë kundër tyre (mësimdhënia për të drejtat e njeriut).
<b>Burimet</b>	Ky ushtrim i stërvit nxënësit të jenë të gatshëm për të studiuar dhe kuptuar vlerat dhe qëndrimet pavarësisht nëse janë apo s'janë në një mendje me to (mësojnë <i>nëpërmjet</i> të drejtave të njeriut). Një listë parashtrimesh ose parullash (shih materialet e mëposhtme). Ndryshe, mund të përdoren afishet e zgjedhjeve, kronika televizive ose pjesë nga pohime ose fjalime nga jeta politike.

### Procedura

1. Nxënësit formojnë çifte ose grupe me nga katër veta.
2. Ata identifikojnë nënkuptimet e pohimeve. Lipset t'u jepen pyetje për t'i drejtuar dhe mundësuar për të bërë krahasime, p.sh. për cilat grupe të shoqërisë mund të ketë pasoja një propozim i caktuar dhe cilat mund të jenë këto (nxënësit do të gjejnë përgjigje të tilla si: të pasurit dhe të varfrit, të shëndetshmit dhe të sëmurët, të fuqishmit dhe të dobët etj.).
3. Në qoftë se nxënësve u janë bërë të njohura qasjet themelore të mendimit politik, atëherë ata mund t'i lidhin propozimet me shkollat e ndryshme të mendimit. Ata mund të gjejnë afri me më shumë se një vijë mendimi.
4. Pohimet dhe vlerat e tyre themelore nxënësit i gjykojnë në dritën e të drejtave të njeriut.

### Zgjerim

Nxënësit diskutojnë pasojat e propozimeve, duke i lidhur me çështjet që diskutohen në vendin e tyre.

### Materialet

#### Lista e propozimeve dhe parullave

1. Shteti nuk duhet të ndërhyjë në drejtimin e ekonomisë. Ai duhet të kufizohet vetëm në zbatimin e ligjit.
2. Kujdesi shëndetësor duhet të sigurohet falas.
3. Të gjitha shoqëritë tregtare duhet shtetëzuar.
4. Kreut të shtetit duhet t'i jepet pushtet i plotë.
5. Shteti, punëdhënësit dhe sindikatat duhet të takohen për vendosjen e normës së rritjes të pagave.
6. Shteti në vetvete është një telash.
7. Qytetërimi i bardhë është më i miri.
8. Nxënësit e dobët duhet penguar të mos lënë prapa në mësim nxënësit e tjerë.
9. Askush nuk ka të drejtë t'u japë urdhra njerëzve të tjerë.
10. Lipset organizimi i shoqërisë në mënyrë që rendi qeverisës të respektojë hierarkinë natyrore të gjërave.



## Ushtrimi 6.2. – Qëndrimet ndaj pushtetit<sup>5</sup>

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit mund të bëjnë dallimin midis koncepteve të pushtetit dhe nëntekstit për demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Nxënësit zhvillojnë të dëgjuarit aktiv (mësimdhënia <i>përmes</i> të drejtave të njeriut).
<b>Burimet</b>	Komplet me shënime të shtypura për nxënësit: «Shpallje mbi pushtetin dhe qeverisjen».

### Procedura

1. Nxënësit ndahen në çifte. Ata studiojnë citimet dhe vendosin se me cilat ndajnë të njëjtin mendim.
2. Ata shkruajnë arsyet që e mbështetin një shpallje të caktuar.
3. Çiftet paraqitin rezultatet e tyre në klasë.
4. Nxënësit identifikojnë shkollat themelore të mendimit politik; mësuesi përdor përfundimet dhe diskutimin në klasë për t'i njohur nxënësit me qasjet (e zgjedhura) e mendimit politik (qasja induktive, që lejon përdorimin e metodave të ndryshme – leksionet e mësuesit e ndoshta vetë nxënësit; studimi i fragmenteve).

### Zgjerim

Nxënësit reflektojnë për sistemet e vlerave të tyre individuale.

Nxënësit i lidhin idetë politike me politikën e partive dhe drejtuesve politikë në vendin e tyre.

### Materialet

(shih faqen në vijim)

---

<sup>5</sup> Përshtatur nga Claude Paris, *Ethique et Politique*, botimet e C.G., Kebek, 1985.

## Fletë pune për nxënësit

### Citime për pushtetin e qeverinë

1. Roli i drejtuesit në qeveri është mjaft i rëndësishëm e i pazëvendësueshëm.
2. Pushteti tjetëron dhe duhet zhdukur për t'i dhënë mundësi çdo personi të kuptojë potencialin e tij të plotë.
3. Kombet kanë vetëm një armik të rrezikshëm: qeverinë e vet.
4. Pushteti politik duhet të ushtrohet nga njerëz të zgjedhur prej qytetarëve.
5. Partitë politike janë të dëmshme për fuqinë e shtetit për shkak se ato i ndajnë njerëzit dhe shkaktojnë përplasje të kota.
6. Shteti nuk është një grumbull i thjeshtë individësh; ai është një realitet më i lartë dhe më thelbësor se shumica e individëve.
7. Të gjitha format e pushtetit kanë prirjen të bëhen totalitare.
8. Shteti nuk është një qëllim në vetvete, por mjet i domosdoshëm për plotësimin e aspiratave të individit.
9. Shteti është një varrezë e stërmadhe, ku marrin fund të gjitha shprehjet e jetës individuale.
10. Grevat duhen ndaluar ngaqë përbëjnë sfida për pushtetin.
11. Individët ekzistojnë vetëm për shtetin dhe, jashtë tij, janë asgjë.
12. Të rinjtë duhet të marrin pjesë në vendimet që i prekin ata.
13. Për lirinë do të mund të flasim vetëm kur shteti të pushojë së ekzistuari.
14. Mësuesi duhet të marrë parasysh kërkesat e ligjshme të nxënësve të tij.
15. Qenieve njerëzore u vjen natyrshëm të bëjnë mirë; ne gjithmonë duhet të kemi besim tek ta.
16. Pjesëmarrja në pushtet e të gjithë individëve duhet të jetë parim themelor i organizimit të të gjitha bashkësive njerëzore.
17. Partitë politike duhet të bëjnë të mundur që aspiratat e qytetarëve të ndikojnë në vendimet e qeverisë.
18. Qeniet njerëzore, nëse lihen pa kontroll, do ta vritnin njëri-tjetrin.
19. Pushteti politik nuk duhet të jetë në mëshirën e opinionit publik.
20. Qeniet njerëzore gëzojnë të drejta që pushteti duhet t'i nderojë dhe nxitë.

## Ushtrimi 6.3. – Sikur të isha magjistari

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit nxiten të krijojnë vizione domethënëse. Personat pa vizione utopike janë të detyruar të pranojnë gjendjen e pandryshuar.
<b>Burimet</b>	Nxënësve u jepet mundësia të përdorin dhuntitë që kanë (krijimtarinë). Letër dhe një stilolaps shënjes.

### Procedura

1. Nxënësve u kërkohet ta përfytyrojnë veten në rolin e një magjistari.
2. Ata lexojnë:  
«Po të isha magjistari i madh, atëherë burrat, gratë dhe fëmijët do t'i organizoja që kurrë të mos përjetonin përsëri, atë që u ka ndodhur gjatë luftës, dhe që kjo të ndodhë...»  
Çdo nxënës plotëson fjalitë e mëposhtme:
  - Unë do të ndaloja...
  - Unë do të mbyllja...
  - Unë do të harroja...
  - Unë do të kundërshtoja...
  - Unë do të vazhdoja...
  - Unë do të krijoja...
3. Me radhë, nxënësit lexojnë me zë përgjigjet e tyre në një sesion plenar. Është e këshillueshme që karriget të vendosen në trajtë rrethi.
4. Vlerësimi: nxënësit nxjerrin në pah dhe diskutojnë se ç'dëshira dhe nevoja kanë zbuluar.

### Zgjerim

Nxënësit merren me çështjen nëse mund të bëhet diçka për të plotësuar një prej dëshirave të tyre.

### Variacion

Për nxënësit më të rritur:

«Po të isha arkitekt...»: nxënësit përfytyrojnë se si mund apo duhej të ishte shkolla ose fshati a qyteti ku banojnë.

Nxënësit mund të reflektojnë për dëshirat e tyre dhe t'i lidhin me traditat themelore të mendimit politik (liberal, konservator, socialist, miqve të tokës).



## Kreu 7 – Pjesëmarrja në politikë



### Hyrje

Në figurë tregohet një burrë dhe një grua, që mbështeten nga një djalë dhe një vajzë, të cilët mbrojnë kauzat e tyre në publik. Afishja e burrit tregon globin si simbolin e botës, ndërsa gruaja tërheq vëmendjen drejt yllit me pesë cepa në afishe, të cilën e mban djali që e mbështet atë. Ndoshta, ky simbol përkon me sipërfaqen ku qëndrojnë ata. Shprehjet e tyre janë miqësore, nuk ka asnjë shenjë armiqësie. Në politikë marrin pjesë të rriturit dhe fëmijët. Ata përdorin të drejtën e tyre për të demonstruar paqësisht në publik. Të dyja palët përbëhen nga persona të të dyja gjinive, prandaj çështja e gjinisë nuk është në rrezik. Të dyja grupet po konkurrojnë – për të pasur vëmendjen dhe mbështetjen e shumicës. Ata ballafaqohen drejtpërdrejt, kështu që asnjë medie, parti politike ose grup interesi nuk është e përfshirë.

Katër njerëz qëndrojnë në një sipërfaqe që përngjan me një yll me cepa të çrregullt. Ky simbol mund të lexohet në mënyra të ndryshme. Mund të paraqitë shoqërinë që qytetarëve të saj u jep ndjenjën se i përkasin njëri-tjetrit dhe gjithashtu krijon kuadrin e të drejtave, përgjegjësisë dhe detyrave. Po ashtu, ylli mund të ngjajë me «sallën» që përdorin qytetarët kur flasin në publik. Kushdo që zgjedh të qëndrojë jashtë kësaj sale nuk do të dëgjohet dhe duhet të pranojë vendimet që merren në fund. Qytetarët mund të marrin pjesë në politikë në shumë mënyra. EQD/EDNJ përqendrohet në mënyrat e pjesëmarrjes aktive, të drejtpërdrejtë. Jo vetëm të rriturit, por edhe fëmijët gëzojnë të drejtën të marrin pjesë në politikë. Bërja e kësaj kërkon të kuptuarit e çështjes dhe vendimmarrje të kujdesshme. Pjesëmarrja politike në demokraci lipset të mësohet nëpër shkollë, e cila, nga ana e vet, kërkon që ato të veprojnë si mikro-shoqëri, që u japin nxënësve mundësinë për të marrë pjesë në administrimin e çështjeve të tyre shkollore.

Në shkollë dhe shoqëri demokratike, argumenti dhe polemika, madje edhe grindjet e mosmarrëveshjet, nuk duhen pasur frikë, por duhen parë si diçka e zakonshme, madje e dobishme në vendimmarrjen demokratike. Zgjidhja e përplasjes së ideve dhe interesave është metoda themelore për zgjidhjen e problemeve dhe marrjes së vendimeve. Nëse interesat dhe kundërshtimet nuk shprehen, atëherë ato nuk mund të merren parasysh. Në një shoqëri të hapur, harmonia – e «mira e përbashkët» – nuk mund të imponohet, por duhet të arrihet nëpërmjet zhvillimit të bisedimeve. Debati dhe mosmarrëveshjet nuk janë të dëmshme nëse fillojnë dhe përkrahen nga kultura e argumentit, e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe e bërjes së kompromisit.

Ushtrimet përqendrohen në rrethanat e kuadrin dhe të mënyrave të pjesëmarrjes politike. Kjo i ndihmon nxënësit të vlerësojnë mundësitë e tyre për pjesëmarrje në shoqëri.

## Ushtrimi 7.1. – Muri i heshtjes

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit ndërgjegjësohen lidhur me konceptet e tyre për demokracinë.
<b>Burimet</b>	Tabelë e fiksuar në mur dhe shënjesit (për grupet me nga pesë veta).

### Procedura

1. Nxënësit formojnë grupe prej pesë vetash. Çdo grup është ulur në gjysmërrethi, përballë një tabele të vendosur në mur. Atyre u kërkohet të shkruajnë, në heshtje dhe brenda një kohe të caktuar, një temë të tipit: «Demokracia është...»
2. Nxënësit u përgjigjen fjalive ose fjalëve të shkruara që më parë.
3. Pasi afati kohor për shkrimin në afishe mbaron, çdo nxënës zgjedh dhe lexon me zë një fjali që nuk e ka shkruar vetë. Nxënësit ndajnë rezultatet e tyre në klasë.
4. Mendimet plotësojnë pjesët e mëposhtme:
  - «Unë kam mësuar...»
  - «Unë kam zbuluar...»
  - «Unë do të doja të diskutoja...»

### Variacion

Nxënësit, në vend që të përdorin afishen e varur në mur, ulen rreth një tryeze shkrimi mbi një tabak të madh letre.

### Informacione të përgjithshme

«Muri i heshtjes» është një metodë që nxit lindjen e ideve dhe mund të përdoret në fillim të një veprimtarie mësimore, sidomos për koncepte kyçe të tilla si: demokracia, diktatura, drejtësia, paqja, arsimi, barazia, liria etj.

Kjo metodë mbështet nxënësit që janë të ndrojtur ose që duan pak kohë për t'u menduar me kujdes, para se të thonë diçka. Nxënës të tillë, zakonisht ndihen në një pozitë më të ulët se të tjerët, sepse e kanë të vështirë të flasin dhe të përballen me mjedisin e klasës.

## Ushtrimi 7.2. – Ndjenjat e mia për diktaturën

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit përcaktojnë dhe gjykojnë elementet e demokracisë dhe të diktaturës. Nxënësit zgjedhin me kujdes vlerat dhe i argumentojnë.
<b>Burimet</b>	Afise dhe shënjes ose dërrasë e zezë dhe shkumës.

### Procedura

1. Nxënësve u kërkohet që të përkufizojnë tiparet kryesore të diktaturës.  
Lista mund të përmbajë pikat e mëposhtme:

- antisemitizmi	- roli i grave si riprodhuese
- spastrimi etnik	- shtypja e pakicave seksuale
- tortura	- nënshtrimi ndaj autoritetit
- kushtëzimi	- trysnia nga bashkëmoshatarët për t'u përshtatur
- kulti i pushtetit, individëve ose i ushtrisë	- kërkesa për t'u udhëhequr
- vlerësimi i kritikës si shkatërruese	- mospranimi i pakicave

2. Nxënësit, duke iu referuar listës, përpiqen t'i përgjigjen pyetjes: «Deri në ç'shcallë kjo gjendje ndikon tek unë?»
3. Nxënësve u kërkohet që gjërat e mësipërme t'i vendosin në një peshore, duke filluar me tiparet që i kanë më shumë për zemër.

### Zgjerim dhe variacion

Veçoritë e diktaturës mund t'i lidhni me shembuj nga buletinet e lajmeve, filmave ose teksteve shkollore.

I njëjti ushtrim mund të bëhet edhe për demokracinë.

## Ushtrimi 7.3. – Pyetësi për qëndrimet ndaj ndryshimeve

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit reflektojnë mbi qëndrimet e tyre dhe i shprehin lirisht ato. Nxënësit mund të dëgjojnë edhe shokët e tjerë, pa marrë parasysh nëse ata bien në një mendje me njëri-tjetrin apo jo.
<b>Burimet</b>	Shënime të shtypura për nxënësin: «Pyetësi mbi qëndrimet ndaj ndryshimeve».

*Shënim për mësuesin*

### Informacion mbi qëndrimet themelore politike

*Qëndrimi* është prirja për të shprehur një mendim ose për të pranuar një formë sjelljeje të caktuar. Ajo vjen si pasojë e përfshirjes shoqërore dhe e historisë vetjake, e, për këtë arsye, qëndrimi është më pak i ndërgjegjshëm se ideologjia. Qëndrimet «udhëheqin» perceptimet, vendimet dhe veprimet tona.

Qëllimi i këtij ushtrimi është të kuptojmë, duke u nisur nga shprehja e mendimeve, se deri në çfarë masë, një person është në mbështetje ose në kundërshtim me një ndryshim shoqëror. Ndryshimi, në vetvete, nuk është as i mirë e as i keq, dhe qëllimi nuk është të gjykojmë nxënësit, aq më pak të vlerësojmë ata. Po ashtu, duhet pasur parasysh se përfundimet e «provës së lakmuesit politik» nuk duhen marrë me gjithë mend, veçanërisht në qoftë se nxënësit nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për pasojat e një deklarate që përfshihet në pyetësor.

Çështja e vërtetë është: pse, çfarë, kur dhe si mund të ndryshojmë. Modelet e mendimit politik që shërbejnë si udhëzime për qëndrimet politike janë zhvilluar që nga epoka e revolucioneve franceze dhe amerikane. Skica e mëposhtme shërben si udhëzues në vija të trasha, por nuk mund të zëvendësojë leximin nga burimet origjinale.

Një qëndrim *përparimtar* çon në bindjen që ndryshimet janë të dëshirueshme. Ato mund të jenë revolucionare ose reformuese, në varësi të urgjencës së perceptuar dhe të mjeteve në përdorim. Për *revolucionarin*, nuk përjashtohet as përdorimi i dhunës, nëse kjo gjykohet e nevojshme. Për reformuesin, ndryshimi është i dëshirueshëm, por pa shpëputje radikale me të kaluarën.

Nga ana tjetër, një qëndrim *konservator* vlerëson traditën dhe parapëlqen përvojën në raport me teorinë. Kjo mund të favorizojë gjendjen ekzistuese ose reaksionin. Të favorizosh gjendjen ekzistuese, do të thotë ta ruash atë si të pranueshme, edhe pse është me të meta. Rritja organike mund të përkrahët si mënyrë ndryshimi (Edmund Burke). Shqetësimi kryesor është që shtetin ta mbash të fortë dhe të zhdërvjellët, në mënyrë që ai mos mbingarkohet nga pjesëmarrja e tepruar dhe interesat partiake. Megjithatë, reaksionari nuk e pranon gjendjen e tanishme të gjërave: ai ka bindjen se nuk ka gjë më të gabuar se sa ndërmarrja e ndryshimeve dhe dëshiron të kthehet në gjendjen e mëparshme.

*Revolucionari* dhe *reaksionari* priren të jenë *doktrinarë*, domethënë, fundamentalistë, gjë që do të thotë se qëndrimet i mbrojnë duke u mbështetur tek ideologjia, pa marrë parasysh të vërtetën e tanishme.

Të tjerët janë më pragmatikë dhe i përcaktojnë pozicionet e tyre duke analizuar pasojat e menjëhershme.

Ky ushtrim, në vija të përgjithshme, mund të shërbejë si një udhëzues që t'i bëjë nxënësit të kuptojnë ekzistencën e modeleve të ndryshme të menduarit politik dhe të bëhen të vetëdijshëm për prirjet dhe parapëlqimet vetjake. Shpesh qëndrimet politike, në jetën politike, dalin se ngjajnë me një politikë të pleksur me modelet themelore të mendimit politik, kur neoliberali, ekologu ose teknokrati argumentojnë pikëpamjet e tyre.



## **Procedura**

1. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve. Ata, para çdo pohimi, shkruajnë numrin që dëshmon qëndrimin e tyre, sipas kodit të mëposhtëm:

- 5 – Ata janë plotësisht në favor të deklaratës.
- 4 – Ata janë pak a shumë në favor të mendimit të pohuar.
- 3 – Ata janë pak a shumë asnjëherë në lidhje me mendimin e shprehur.
- 2 – Ata janë pak a shumë kundër mendimit në fjalë.
- 1 – Ata janë plotësisht kundër deklaratës.

2. Nxënësit mbledhin shumën e përgjithshme të pikëve, e cila tregon, në një farë mënyre, qëndrimin e tyre politik.

- 100-80: revolucionar
- 80-60: reformist
- 60-40: në favor të ruajtjes së gjendjes
- 40-20: reaksionar

A ka mosmarrëveshje të dukshme mes nxënësve, sidomos midis djemve dhe vajzave?

## **Zgjerim**

Puna me tekstet: në varësi të mënyrës së përdorimit të këtij teksti – si një ushtrim që bëhet në fillim apo në fund të materialit – këshillohet që puna me tekstin të bëhet para apo të pasojë këtë ushtrim. Për klasat e përparuara mund të zgjidhen pjesë nga autorë të tillë si Lok, Bërk ose Marks. Përveç kësaj ose si zgjidhje për nxënësit më të vegjël, mund të jenë të përshtatshme deklaratat e politikanëve ose të përfaqësuesve të partive për çështje të veçanta. Shiko edhe ushtrimin e mëposhtëm.

## **Variacion.**

Këto pyetje mund të formulohen mbështetur më shumë në shqetësime të zonës përreth.

Ndonjë prej pyetjeve mund të shërbejë si pikënisje për debat.

## **Materialet**

(Shih faqen në vijim)

## Fletë pune për nxënësin

### Pyetësor për qëndrimet që duhen ndryshuar:

1. Një grua duhet të ketë mundësi të sterilizohet pa lejen e burrit.
2. Informacioni për kontrollimin e lindjeve duhet të jetë i arritshëm, sipas kërkesës, për të gjitha vajzat e reja katërmëdhjetëvjeçare ose mbi këtë moshë.
3. Drogat e lehta duhet të ligjërohen.
4. Referendumet në demokraci duhet të mundësohen me kërkesë popullore.
5. Kriminelët kanë nevojë për kujdes mjekësor , më shumë se për ndëshkim.
6. Dënimi me vdekje duhet të hiqet plotësisht.
7. Shoqëritë e mëdha tregtare duhen shtetëzuar.
8. Martesat mes njerëzve të së njëjtës gjini duhet të jenë të ligjshme.
9. Në ofertat e punës nuk duhet të kërkohet përcaktimi i gjinisë.
10. Institucionet bamirëse duhet të ndalohen. Shteti e ka për detyrë t'u vijë në ndihmë njerëzve të braktisur.
11. Personat e zakonshëm nuk kanë nevojë t'i drejtosh ose t'i kontrollosh.
12. Nxënësi duhet të marrë pjesë në drejtimin e shkollës ku mëson.
13. Notat dhe diplomat duhet të shfuqizohen.
14. Kujtdo i duhet siguruar një e ardhur minimale, pavarësisht nga gjinia, mosha dhe profesioni, madje edhe nëse vendosin të mos punojnë.
15. Fëmijët duhen rritur me disa besime njëkohësisht; zgjedhjen mund ta bëjnë vetë në moshë të rritur.
16. Udhëheqësit politikë duhet të ndjekin këshillën e shkencëtarëve për përdorimin e zbulimeve shkencore.
17. Të gjitha qeniet njerëzore lindin me të njëjtin potencial.
18. Prona private duhet të ndalohet dhe të hyjë në fuqi pronat shtetërore.
19. Askush nuk ka të drejtë t'ia imponojë mendimin e tij të tjerëve.
20. Duhet ndaluar prodhimi i të gjitha produkteve ndotëse, pavarësisht nga ndikimi i tyre i menjëhershëm ekonomik.

## Ushtrimi 7.4. – Projekti i planifikimit<sup>6</sup>

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit kuptojnë strukturat e varësisë së ndërsjellë në një bashkësi gjatë një periudhe ndryshimi. Nxënësit kuptojnë se çdo vendim përfshin tërë anëtarët e bashkësisë. Andaj, që vendimet të pranohen dhe të mbështeten, duhet që të gjithë anëtarët e bashkësisë t'i kuptojnë dhe të kenë mundësinë të marrin pjesë në ecurinë e vendimmarrjes.
<b>Burimet</b>	Përshkrimi i një projekti të planifikuar, të vërtetë ose të përfytyruar, në një lagje qytetëse. Ai duhet të marrë parasysh anën shoqërore, ekonomike, demografike, të transportit, si dhe probleme të tjera. Mësuesi duhet të përgatitë një grup skedash për aktorët në lojën e shtirë. Shembujt e mëposhtëm mund të shërbejnë për t'i dhënë lexuesit një ide se si një projekt planifikimi i vërtetë mund të mund të simulohet në lojën e shtirë.

### **Shënim për mësuesin**

Ky ushtrim përmban shumë pikësnyime të fshehura brenda. I takon mësuesit të vendosë se cila nga këto elemente duhet të diskutohet në mënyrë të qartë dhe cila vetëm sa e ndihmon atë të kuptojë dhe t'u shpjegojë të tjerëve se cila mund të jetë pasoja e mundshme e të mësuarit.

1. Nxënësit zhvillojnë gatishmërinë për të dëgjuar e për të kuptuar pikëpamjet dhe interesat e ndryshme, pavarësisht nëse pajtohen apo jo me to.
2. Nxënësit mësojnë të parashikojnë pasojat dhe domethëniet e zgjedhjeve në ecurinë e vendimmarrjes.
3. Nxënësit përjetojnë marrjen e vendimeve në kuadrin demokratik. Kjo kërkon gjetjen e drejtpeshimit midis pjesëmarrjes dhe frytshmërisë (p.sh., të gjithë duhet ta thonë fjalën e tyre, por duhet të ketë një afat kohor për çdo kontribut dhe për ecurinë në tërësi).
4. Ideja themelore: në një komunitet të hapur, d.m.th., komunitet të mësuarit, e mira e përbashkët (vullneti i përgjithshëm) nuk përcaktohet nga çdo autoritet, por pranohet me anë të një vendimi të përkohshëm, që është i hapur për rishikim nëse ndodhin probleme të reja.

### **Procedura**

1. Nxënësit ndahen në çifte. Çdo palë merr një kopje të projektit dhe një nga skedat. Një çift nxënësish kryeson debatin që vijon.
2. Çiftet hartojnë një listë me të gjitha dobitë dhe problemet që lidhen me projektin.
3. Ata e bëjnë këtë të nisur nga pikëpamja e personit, rolin e të cilit luajnë.
4. Ata marrin një vendim të përbashkët, pro apo kundër projektit (15 minuta).
5. Nga ana tjetër, secili çift i paraqet grupit qëndrimin e tij dhe shpjegon arsyet e tij.
6. Në një debat, çdo çift ka për të thënë atë që do të donte ta shihte të zbatohet. Për çdo nxënës dhe për tërë debatin duhet të vendoset afati kohor.
7. Nxënësit votojnë në mënyrë që të zbatohet apo jo projekti.

### **Vazhdimi i punës**

1. A ka grupe të tjera, vlerësimet e të cilave duhet të merren parasysh?

<sup>6</sup> Përshtatur nga S. Fountain, *Education pour le développement humain*, De Boeck, 1996

2. Deri në ç'shikallë mendimi juaj u ndikua nga ai i të tjerëve?
3. A ndikojnë interesat e veçanta që mbrohen nga njëri prej grupeve, te grupet e tjera?
4. A ka grupe mendimet dhe interesat e të cilave meritojnë më shumë rëndësi?
5. A ka grupe mendimet e të cilave, janë dëgjuar rrallë ose asnjëherë?
6. A ka ndonjë zgjidhje të votuar nga shumica e cila përfaqëson zgjidhjen më të mirë për mbarë shoqërinë?

### **Zgjerim**

1. Nxënësi, si individ, luan një rol të caktuar pa ndihmën e një bashkëpunëtori.
2. Loja me role përfshin dëgjimin e ekspertëve që mund të tregojnë anë të veçanta të projektit.
3. Një pjesë e klasës vepron si juri ose parlament vendor, që merr vendimin përfundimtar, për disa grupe të caktuara të interesit, pa avokatët (demokracia përfaqësuese).
4. Dy ose tri nxënës të veprojnë si gazetarë dhe vëzhgues. Ata vëzhgojnë ecurinë e vendimmarrjes dhe rolet që luhen nga nxënësit.
5. Nëse në lojën me role simulohet një proces i vërtetë vendimmarrjeje, në klasë mund të ftohen politikanë ose gazetarë vendorë, për të ndjekur nga afër diskutimin me nxënësit.
6. Ky model mund të përdoret për të organizuar një proces të vërtetë vendimmarrjeje në shkollë.

### **Materiale për mësuesit**

#### **Pyetje për përcaktimin e skedave në lojën me role**

1. Ju jeni mësues:
  - A mund të jepni arsyet tuaja përse projekti është një ide e mirë?
  - A mendoni se ai mund të paraqiste ndonjë problem?
2. Jeni pronar i një shoqërie të vogël tregtare:
  - A mund të jepni arsyet tuaja përse projekti është një ide e mirë?
  - A mendoni se ai mund të paraqiste ndonjë problem?
3. Ju punoni në një qendër mjekësore.
4. Ju punoni si grumbullues mbeturinash.
5. Ju jeni një shofer autobusi.
6. Kohët e fundit keni ardhur nga ndonjë vis a vend tjetër dhe kërkoni punë.
7. Jeni i një i ri që punoni në lagje.
8. Jeni administratori i një shoqërie të vogël tregtare.
9. Jeni përfaqësues politik.
10. Etj.

## Ushtrimi 7.5. – Ne dhe bota

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit shqyrtojnë se si vendet e tjera dhe ngjarjet e largëta ndikojnë në komunitetin e tyre. Nxënësit e kuptojnë më mirë përbërjen e ndërvarësisë në botë. Shpërndarja e pabarabartë e pushtetit dhe ecuria e pabarabartë e zhvillimit kërkon mirëkuptim dhe bashkëpunim mbarëbotëror, në frymën e të drejtave të njeriut.
<b>Burimet</b>	Gazetat e sotme vendore, harta e botës, shirit ngjitës dhe lapustila, fill, gjilpëra.

### Procedura

1. Nxënësit formojnë grupe me nga katër veta. Ata presin artikujt që tregojnë se një pjesë e botës ka ndikim në bashkësinë e tyre vendore dhe se vendi i tyre dhe vendet e tjera ndikojnë në mënyrë të ndërsjellë te njëri-tjetri.
2. Çështjet:
  - problemet ekonomike
  - problemet politike
  - probleme të migrimit
  - ndotja
  - shkëmbimi kulturor
  - turizmi
  - veprimi ushtarak etj.
3. Nxënësit i renditin artikujt sipas fjalëve kyçe që zgjedhin për të treguar disa lloje ndikimi dhe fjalët kyçe u veshin ngjyra.
4. Nxënësit zgjedhin artikujt më të rëndësishëm dhe i lidhin me shirit në hartën e botës të varur në mur. Ata ndjekin shiritat që lidhin të gjithë artikujt me fill dhe gjilpëra me vendin e tyre.
5. Seanca plenare
  - Me cilën pjesë të botës keni vendosur më tepër lidhje?
  - Ç'lidhje janë më të zakonshme? Pse?
  - A ka ndonjë pjesë të botës me të cilën nuk gjeni asnjë lidhje? Pse?

### Zgjerim

Nxënësit të gjejnë informacion për sistemet politike dhe/ose ekonomike që janë në fuqi në vendet me të cilat kanë lidhje.

Ata mund të shohin nëse në të kaluarën kanë ekzistuar lidhjet e tjera.

Në mësimdhënien e gjuhës së huaj, mund të përdoren materiale nga gazetat e huaja ose nga interneti.

Ky ushtrim mund të shërbejë si hyrje për problemin e zhvillimit të pabarabartë dhe shpërndarjen e pushtetit në botë.

Perceptimi që kemi për botën ku jetojmë përftohet nga informacioni që ne marrim, jo drejtpërdrejt, por nga media. Mendoni pak se deri ku mund të arrinit ju, sikur t'i njihnit vetëm vendet e botës që e keni parë. Pra, çfarë na tregon media dhe çfarë informacioni nuk na e përcjell neve? A duhet ta kontrollojë dikush medien? Ndokënd që e censuron atë? Apo, konkurrenca midis gazetave të ndryshëm e realizon këtë qëllim? Sa e fuqishme është media? A mund të jetojmë dot pa të? Në klasë mund të shtrohen pyetje të tjera të ngjashme, por ato duhet

t'i ngrenë nxënësit e jo mësuesi. Nëse nxënësit e kuptojnë se sa e kufizuar është rrezja e perceptimit të tyre të drejtpërdrejtë, atëherë ata vetë mund të fillojnë të drejtojnë pyetje për rolin e medias.

## Ushtrimi 7.6. – A duhet të marrësh pjesë në politikë?

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit krijojnë mendimin e tyre për rëndësinë e pjesëmarrjes në qeverisje. Pjesëmarrja mund të bëhet në shumë mënyra. Pjesëmarrja përkufizohet si marrja pjesë në jetën publike të bashkësisë dhe shoqërisë tuaj. Disa njerëz mendojnë se pjesëmarrja është e rëndësishme, ndërsa të tjerë, jo. Nxënësit duhet të kuptojnë se vendimet politike ndikojnë tek ta, pavarësisht nëse marrin apo jo pjesë në vendimmarrje.
<b>Burimet</b>	Skedat e roleve për lojën me role.

### Procedura

1. Katër nxënës sajojnë bashkëbisedimin mes disa qytetarëve që sapo kanë ardhur në një komb gjatë ecurisë së krijimit të tij.
2. Nxënësit diskutojnë, të udhëhequr nga mësuesi nëse është e nevojshme, pyetje të ngritura nga loja me role, të tilla si:
  - Cilat janë katër pikëpamjet kryesore të shprehura nga qytetarët për pjesëmarrjen? A jeni i të njëjtit mendim me to? Pse po, ose pse jo?
  - Çfarë humbasin katër qytetarët duke mos marrë pjesë? Ç'dobi mendoni se do të nxjerrin nga pjesëmarrja?
  - Ç'dobi mendoni se do të fitojë një shtet i ri nga individët që marrin pjesë?
  - Cilat janë rreziqet ose humbjet e mundshme të përfshira nëse dikush zgjedh të marrë pjesë?
  - Duke peshuar dobitë dhe rreziqet, a besoni se ia vlen për të marrë pjesë?
3. Nxënësit, duke marrë pjesë në diskutim apo në lexim, mund të arrijnë në përfundimin e mposhtëm:

Qeveria ndikon në jetën e njerëzve në shumë mënyra. Njerëzit, duke marrë pjesë në qeverisje, mund të kenë një zë në vendimet që merr qeveria. Në çdo shoqëri dikush do të marrë vendime. Nëse njerëzit zgjedhin të mos marrin pjesë, atëherë ata nuk do të shprehin mendimin e tyre për ato vendime. Këto vendime mund të përfshijnë gjëra të tilla si:

  - sa njerëz do të duhet të paguajnë taksë;
  - nëse shoqëria do të përfshihet në luftë;
  - kush do të zotërojë dhe kontrollojë burimet natyrore të vendit.

Vendimet, në varësi të përbërjes së qeverisë, vendimet mund të merren në nivele të ndryshme, përfshirë atë kombëtar, rajonal dhe vendor. Disa vendime, si ato që kanë lidhje me fuqinë ushtarake, shpesh merren në nivel kombëtar, ndërsa të tjerat, si ato në lidhje me transportin dhe rrugët, shpeshherë merren në nivel rajonal. Të tjerë akoma, siç janë ato në lidhje me grumbullimin e mbeturinave, shpesh merren në nivel vendor.

### Materialet

(shih faqen në vijim)

**Loja me role: katër qytetarë shkojnë në një vend të sapoformuar.**

Ta zëmë sikur ju sapo keni mbërritur në një vend të sapoformuar. Juve nuk iu durohet, derisa të të nisni të ndërtoni një shoqëri të re. Keni dëgjuar se atje janë të gjitha mundësitë për të krijuar një qeverisje të mirë. Pastaj, ju kap veshi bisedën e mëposhtme mes një grupi të sapoardhurish si puna juaj:

**Qytetari 1:**

“Andej nga vij unë, askush nuk mendonte për politikën dhe qeverisjen, sepse gjithmonë ishim shumë të zënë me jetën e përditshme. Kështu që, edhe këtu, ka shumë mundësi të mos mendoj për të”.

**Qytetari 2:**

Në vendin tonë ndodhte kështu... dhe kurrë nuk e kam kuptuar me të vërtetë se ç'ndodhte mes udhëheqësve. Ata na e bënë politikën tepër e koklavitur dhe na e bënë mjaft të lehtë që të mos e merrnim mundimin për ta kuptuar atë”.

**Qytetari 3:**

Epo, në vendin tonë ndryshonte puna. Ne u përpoqëm, por njerëzit që kishin pushtetin nuk na lejonin të përfshiheshim dhe na kërcënonin sa herë që e provonim. Pra, në fund, hoqëm dorë nga pjesëmarrja”.

**Qytetari 4:**

Ne në vendin tim mbanim zgjedhje dhe udhëheqësit tanë na premtorin qeverisje të mirë. Por ajo kurrë nuk u plotësua. Udhëheqësit e përdorën qeverisjen për t'u pasuruar. Të gjithë udhëheqësit janë të korruptuar.



## Ushtrimi 7.7. – Si ndikon qeveria në jetën tuaj?

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit kuptojnë se qeveria ndikon në jetën tonë në gati çdo drejtim të imagjinueshëm ( <i>tua res agitur</i> ). Bota ku jetojmë është e përbërë nga njerëzit dhe prandaj varet nga ne se çfarë bëjmë me të. Vendimmarrja politike e qëllimshme është e nevojshme për shkak të varësinë sonë gjithnjë në rritje ndaj njëri-tjetrit, nga niveli vendor deri në atë botëror. Demokracia mund të marrë më së mirë parasysh interesat konkurruese dhe t'i përfshijë në një kompromis të kënaqshëm – me kusht që të dëgjohen gjitha grupet.
<b>Burimet</b>	Asnjë

### Procedura

1. Nxënësit duhet të kuptojnë se, deri në çfarë mase, jeta e tyre ndikohet nga qeveria. Për t'i ndihmuar në këtë drejtim shërbejnë pyetjet e mëposhtme; nxënësit mund t'u përgjigjen atyre në klasë ose në grupe të vogla; përfundimet do t'i paraqiten në seancën plenare.
2. – Tregoni një histori tuajën të kohëve të fundit: ku shkuat, çfarë veshët, çfarë patë, çfarë hëngrët, çfarë thatë, çfarë mësuat dhe çfarë bëtë. Tregoni në listën e gjërave të lartpërmendura ato që, sipas mendimit tuaj, janë ndikuar nga qeveria, qoftë ajo kombëtare, rajonale dhe/ose lokale.  
- E zëmë sikur qeveria juaj është demokratike dhe të gjithë qytetarëve u është dhënë mundësi e barabartë që të marrin pjesë, pa u shkelur të drejtat e tyre të njeriut. Cila nga pikat e jetës tuaj të përditshme, që ju përmendët në listë si të ndikuar nga qeveria, mendoni se do duhet të ndryshojë? Shpjegoni arsyen pse ato duhet të ndryshojnë.
3. Ka shumë mundësi që nxënësit të shtrojnë pyetjen se si njerëzit mund të marrin pjesë në qeverinë demokratike. Mësuesi duhet të japë disa të dhëna për këtë qëllim, nëpërmjet leksioneve, duke u mbështetur te ndonjë libër mësimor ose fletë pune.

Rezultati mund të jetë si vijon: shumë njerëz besojnë se mundësia më e madhe për të marrë pjesë në qeveri jepet në një demokraci të lirë dhe të hapur. Kjo lloj qeverisjeje nënkupton që njerëzit e fitojnë vetë pushtetin dhe zakonisht qeverisin përmes sundimit të shumicës. Disa vende janë demokraci vetëm sa për emër dhe njerëzit nuk lejohen realisht të marrin pjesë. Qytetarët, në një sistem demokratik, mund të zgjedhin midis mënyrave të ndryshme të pjesëmarrjes dhe disa, madje, mund të vendosin të mos marrin pjesë në të.

Demokracia mund të marrë më së miri parasysh interesat e ndryshme dhe konkurruese dhe të kërkojë të gjejë zgjidhje të kënaqshme – me kusht që të gjitha grupet të kenë artikulluar pikëpamjet e tyre. Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar grupeve më të dobëta, të cilat nuk janë në gjendje të ushtrojnë trysni e prandaj interesat e tyre kanë prirjen të shpërfillen (problemi i përjashtimit).

## Ushtrimi 7.8. – Mënyrat e pjesëmarrjes në demokraci

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit bëjnë lidhjen midis formave të ndryshme të pjesëmarrjes politike me të drejtat e njeriut.
<b>Burimet</b>	Lista e formave të mundshme të pjesëmarrjes politike.

### Procedura

1. Çdo nxënës shkruan një listë të të gjitha mënyrave dhe veprimtarive me anë të të cilave ai beson se njerëzit mund të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse demokratike.
2. Nxënësit formojnë grupe me nga katër veta. Ata krahasojnë listat e tyre, i diskutojnë dhe përpiqen të merren vesh për një listë të përbashkët të rrugëve të pjesëmarrjes.
3. Grupet krahasojnë listën e tyre të rrugëve të pjesëmarrjes me atë të fletës së punës.

### Zgjerim

Nxënësit mund të shqyrtojnë pyetjet e mëposhtme:

1. A besoni se ndonjë ose të gjitha format e mësipërme të pjesëmarrjes politike janë e drejtë njerëzore? A duhen mbrojtur të gjitha ato nga ligji? Shpjegoni pse po, apo pse jo.
2. Si mund të merrni pjesë në demokraci, në vendin tuaj? A ka mënyra për të marrë pjesë që nuk janë të hapura për ju? Shpjegoni.
3. A duhet që ligjet të mbrojnë të drejtën për të mos marrë pjesë? Shpjegoni.

### Materialet

#### Materialet e nxënësit

Pjesëmarrja mund të marrë shumë forma, duke përfshirë:

- leximin për çështje dhe udhëheqës të ndryshëm
- të shkruarit për çështje dhe udhëheqës të ndryshëm
- debatin për çështje të ndryshme
- punën në komunitet, në mbështetje të një kauze ose në protestë kundër veprimeve të qeverisë
- krijimin ose bashkimin me partitë politike ose bashkësi të tjera, apo organizata bazë të partisë
- ndjekjen e mbledhjeve politike ose ato të komunitetit
- bërjen kryetar i një partie politike, i një organizate punëtorësh ose i një organizatë komunitare
- votimin në zgjedhje
- fushatën për ata që hedhin kandidaturën
- hedhjen e kandidaturës dhe kryerjen e shërbimit në rast zgjedhjeje
- pagimin e tatimeve
- grupet e interesit që përpiqen të arrijnë një qëllim të caktuar, nëpërmjet ndikimit politik
- shërbimin në ushtri
- shfrytëzimin e kanaleve ligjore, si takimi me zyrtarë të qeverisë, çuarja e rasteve në gjykatë etj.
- protestimi nëpërmjet demonstratave, bojkoteve, grevave etj.

## Ushtrimi 7.9. – Cikli politik

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit janë në gjendje të zbatojnë modelin e ciklit politik me shembujt e proceseve vendimmarrëse. Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për mundësitë e ndërhyrjes dhe pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes.
<b>Burimet</b>	Disa fletë pune për nxënësit: «Modeli ciklik i politikës». Letra me figura, disa shënjes, gërshërë, ngjitës

### Procedura


1. Mësuesi paraqet modelin ciklik të politikave, duke përdorur një nga metodat e mëposhtme:
  - Mësuesi shfrytëzon qasjen deduktive sistematike: ai mban një leksion<sup>7</sup> dhe nxënësit vënë në punë mjetet që u janë dhënë.
  - Mësuesi ndjek metodën induktive: ai e fillon me një shembull ose përdor njohuritë dhe përvojën paraprake të nxënësit. Kjo mund të jetë një çështje aktuale, një vendim që e mbështetin ose jo, një problem që i shqetëson. Si pikënisje mund të shërbejë edhe një vendim në shkollë. Mësuesi vijon me një leksion, duke përmendur me takt kontekstin e siguruar nga nxënësit.Çfarëdo metode që të përdoret, nxënësit marrin një kopje të materialit të shtypur «Modeli ciklik i politikës».
2. Nxënësit vënë në zbatim modelin. Mund të jepen detyra të ndryshme:
  - Nxënësit e përdorin modelin si një mjet për leximin aktiv dhe të përqendruar të gazetës. Nxënësit, duke punuar në grupe prej katër deri në gjashtë veta, studiojnë gazetën e ditëve të fundit dhe identifikojnë shembujt për secilën nga gjashtë fazat. Artikujt i ngjiten tek afishet e tyre dhe i paraqitin në seancën plenare.
  - Nxënësit ndjekin ecurinë e vendimmarrjes për një çështje të caktuar. Kjo mund të kërkojë materiale që mbulojnë një periudhë më të gjatë dhe, për këtë arsye, mund të jenë të dobishme edhe gazetatat më të vjetra. Librat dhe interneti mund të jenë burime me rëndësi. Ky ushtrim mund të zhvillohet në një projekt kërkimor.
3. Modeli mund të shërbejë edhe si pikënisje për diskutim: në çfarë faze të një procesi vendimmarrës mund të ndërhyjmë? Mësuesi duhet të shpjegojë se dy fazat, «vendimi» dhe «zbatimi», kufizohen me sistemin politik (më përjashtim të rastit kur vendimi është plebishitar). Por, qytetarët mund të ndërhyjnë në çdo fazë tjetër.

---

<sup>7</sup> Shiko «Informacion në ndihmë të mësuesit» (në pjesën e titulluar Materiale të këtij ushtrimi).

## Materiale

Modeli ciklik i politikës: Politika si proces i zgjidhjes së problemeve



### Modeli ciklik i politikës: informacion në ndihmë të mësuesit

Cikli politik është model. Ai vepron si hartë, që do të thotë se ai zgjedh disa aspekte nga realiteti dhe shpërfill të tjerat. Në këtë mënyrë pamja bëhet më e qartë, por përdoruesit kurrë nuk duhet ta ngatërrojnë modelin me realitetin. Në këtë rast, modeli ciklik i politikës përqendrohet në politikë si procesi i marrjes së vendimeve dhe i zgjidhjes së problemeve. Pikësynimi i saj nuk është te politika, si luftë për pushtet, edhe pse ky aspekt është i dukshëm. Gjashtë kategoritë çojnë në pyetje kyçe që ndihmojnë për analizën e vendimmarrjes politike; nxënësit nxiten të paraqitin pyetje të tjera që janë më të lidhura me kontekstin.

Modeli bën një përshkrim ideal procesit të vendimmarrjes politike. Së pari, problemi politik duhet të arrijë deri në agjendën publike. Çështja e futjes në agjendë ka të bëjë shumë me politikën në fuqi. Problemet nuk ekzistojnë si të tilla; ato duhet të përcaktohen dhe të pranohen. Interesat dhe vlerat konkurruese luajnë rol të rëndësishëm, pasi përkufizimi i një problemi ndikon fuqishëm në rezultatin e vendimmarrjes. Për shembull, varfëria mund të përkufizohet si sulm ndaj të drejtave të njeriut ose si shtysë për ta marrë vetë fatin në dorë. Pikëpamja e parë nënkupton që njerëzit e varfër kanë nevojë për përkrahje, ndërsa e dyta, në mënyrë të heshtur, nuk këshillon të ndihmohen edhe aq të varfrit, meqë kjo mund t'i bëjë ata përtacë. Çështja kryesore e përcaktimit të agjendës tregohet nga shigjetat e dyfishta mes kategorive të *problemit* dhe *debatit*.

*Debati* zhvillohet në kushte të caktuara. Kudri i modelit është i rëndësishëm: zhvillimet shoqërore, ekonomike dhe ndërkombëtare përcaktojnë të dhënat. Kurse kudri kushtetues dhe ligjor përcakton rregullat. Kush mund të marrë pjesë në debat? Kush vendos? Këto pyetje ndihmojnë për të kuptuar rezultatin e debatit, vendimin përfundimtar. Kush ka marrë pjesë në

debat? Çfarë interesash ishin në rrezik? Për çfarë duheshin zhvilluar bisedime? A ishte e mundur gjetja e kompromisit?

*Zbatimi:* Si është paraqitur ose në ç' mënyrë është zbatuar vendimi? A kanë ndodhur vështirësi ose mosmarrëveshje? A i përmbush zbatimi qëllimet e vendimmarrësve?

*Opinione:* Si «kanë zbritur» vendimet? Interesat e kujt janë ndikuar – në mënyrë të favorshme ose të pafavorshme? Cilat vlera janë përfshirë?

*Reagimet:* A ka reagime nga individë dhe/ose kolektive, reagime të organizuara nga grupet? A e mbështetin apo e kundërshtojnë vendimin? Shembujt mund të jenë të tilla si: protestat, demonstratat, letra drejtuar botuesit të ndonjë gazete, vendimet e gjykatave, grevat, imigracioni, largimi i investitorëve, shkelja e ligjit etj.

*Problemi:* Në fund të fundit, a është zgjidhur problemi fillestar? A ka pasur ndonjë pasojë të padëshiruar ose të paparashikuar? A ka lindur ndonjë problem i ri nga reagimet ndaj vendimit dhe zbatimit të tij? Cikli politik përfundon në rast se problemi zgjidhet. Shumë shpesh, fillon një cikël i ri, me një problem tjetër ose të paparashikuar.

Nxënësit duhet të kuptojnë se cikli i politikës tregon se ku dhe si qytetarët mund të marrin pjesë në politikë. Ne mund të japim përkufizimin tonë për problemet që kanë nevojë për vëmendje politike dhe kërkojnë publikun si burim për zgjidhjen e tyre. Ne mund të marrim pjesë në debat, të krijojmë mendimin tonë për vendimin dhe të mbështetim apo kundërshtojmë mënyrën në të cilën është zbatuar. Duke bërë kështu, ne po shfrytëzojmë të drejtat tona njerëzore dhe qytetare. Demokracia varet nga demokratë aktivë.



## Kapitulli 8 – Menaxhimi i konfliktit



### Hyrje

Ilustrimi tregon dy të rinj të përfshirë në një grindje. Ata rrinë ulur përballë njëri-tjetrit në një tryezë. Njëri mban një flamur, ndërsa tjetri shtrëngon grushtin dhe tregon dhëmbët. Flokët u janë ngritur lart, gjë që u jep kundërshtarëve pamjen e egërsirave të pashpirt. Nëse kjo është gjithçka, atëherë do të prisnim që kjo mosmarrëveshje të përshkallëzohej: pas pak dy burrat do të ngriheshin dhe do t'i drejtoheshin dhunës fizike. Por, ka një element të dytë në ilustrim: dy burrat po i shtrëngojnë dorën njëri-tjetrit, në shenjë marrëveshjeje dhe kompromisi. Ata janë vetëm duke folur – ndoshta duke i gërthitur fort njëri-tjetrit – por nuk ka dhunë.

Njëkohësisht figura tregon se çfarë ndodh në vazhdimësi në jetën e vërtetë: nëse ngrihemi për të mbrojtur interesat, pikëpamjet dhe vlerat tona, ndonjëherë do të përfshihemi edhe në konflikte. Ne, për të zgjidhur konflikte të tilla, duhet të kemi të aftë sinë dhe vullnetin për t'u marrë vesh dhe për të bërë kompromis. Së pari, argumentimi, vendosja e skajeve dhe më pas gatishmëria për të kërkuar për t'u marrë vesh dhe për të bërë kompromis, përbën një proces konflikti të ngjashëm me frymëmarrjen dhe frymënxjerrjen..

Dyshemeja në trajtë ylli ka shumë kuptim. Ne kemi të përbashkët komunitetin – për shembull, planetin, familjen, shkollën tonë. Nuk kemi asgjë tjetër. Prandaj, ne varemi nga njëri-tjetri e lindja dhe zgjidhja e konflikteve duhet të drejtohen nga parime dhe rregulla të përbashkëta. Andaj, konfliktet, si të tilla, nuk janë gjë e keqe. Të drejtat e njeriut krijojnë pluralizmin dhe konkurrencën e interesave, të cilat shtojnë gjasat për konflikte. Zgjidhja e duhur e një konflikteve mund të shpjerë në harmoni, ndërsa përpjekjet për t'i shtypur konfliktet apo për t'i zgjidhur në mënyrë të padrejtë ato mund të çojë në përçarjen e komunitetit.

Zgjidhja e konflikteve, deri diku, është aftësi që mund të mësohet. Kjo është në qendër të ushtrimeve të këtij kapitulli; ato u sigurojnë nxënësve mjetet, skemat e strukturuar të procedurës për zgjidhjen dhe ndërmjetësimin e konflikteve. Së dyti, rëndësi ka zgjidhja e drejtë e konflikteve, e kjo ka lidhje me vlerat dhe kulturën e qëndrimit ndaj tyre. E mira e të mirave do të qe që konfliktet të kapërceheshin në dobi të të gjithëve. Në qoftë se kjo s'është e mundur, duhet pasur kujdes që të mos krijohen humbës, por, më tepër, të gjendet kompromisi që ruan baraspeshën mes dobive dhe humbjeve. Në një këndvështrim më të gjerë, aktorët e mundshëm përfshijnë jo vetëm kundërshtarët që janë të përfshirë drejtpërdrejt, por edhe komunitetin dhe mjedisin në tërësi.

## Ushtrimi 8.1. – Zgjidhje të leverdishme për të gjitha palët

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit kuptojnë se ka mënyra të ndryshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Palët e përfshira mund të jenë në pozitën e fituesit a të humbësit, por mundet që të dyja të merren vesh për të rënë në kompromis. Asnjë palë nuk duhet të mendojë se është humbëse, pasi kjo mund të çojë në një shpërthim tjetër mosmarrëveshesh
<b>Burimet</b>	Dërrasë e zezë ose letra me figura shpjeguese

### Procedura

1. Mësuesi u shpjegon nxënësve se mund ketë tri lloje të ndryshme zgjidhjesh për konfliktet:

<b>fitues – fitues</b>	☺☺
<b>fitues – humbës</b>	☺☹
<b>humbës – humbës</b>	☹☹

Ai i ilustron këto parime që kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve në dërrasën e zezë ose në një tabak të madh letre.

**Fitues-fitues:** zgjidhje që u lejojnë të dyja palëve të dalin të fituara

**Fitues-humbës:** zgjidhje ku vetëm njëra palë fiton në kurriz të tjetrës

**Humbës-humbës:** zgjidhje ku asnjëra nga palët nuk nxjerr dobi.

2. Mësuesi jep shembuj mbi mënyrat e ndryshme të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve:  
Një djalë dhe një vajzë grinden për një top. Ndërhyn një i rritur që i bën të luajnë së bashku me topin ose u jep atyre kohë të barabartë për ta përdorur atë. Dobi nxjerrin si njëri, si tjetri. Nëse i rrituri ia jep topin vetëm njërit prej tyre, doemos që vetëm njëri përfiton. Nëse i rrituri e merr topin me vete, meqë fëmijët nuk merren dot vesh, atëherë asnjëri prej tyre nuk përfiton.
3. Nxënësit, në çifte ose në grupe, shqyrtojnë përvojat e tyre për të gjetur shembuj të tjerë konfliktesh. Ata mund të diskutojnë përvojat e tyre rreth konflikteve në shtëpi e shkollë dhe mund të vazhdojnë me konfliktet më të mëdha që përfshijnë grupe njerëzish dhe shtete të tëra.
4. Nxënësit analizojnë shembuj të zgjidhjeve të konflikteve, të cilat i identifikojnë duke përdorur modelin e paraqitur më sipër, duke pyetur se cila palë do të nxjerrë dobi nga zgjidhja. Kush mund të gjejë zgjidhje që lejojnë të përfitojnë të gjitha palët?
5. Seanca plenare: nxënësit ndajnë rezultatet e analizës së tyre.

### Variacion

Nxënësit, pas hapit 2, marrin përshkrimin e rastit të një konflikti. Ata, në grupe, përpiqen të gjejnë një zgjidhje që shmang krijimin e humbësve. Nëse konflikti ka qenë i zgjidhur, atëherë nxënësit mund ta krahasojnë zgjidhjen e tyre me atë të gjetur në praktikë dhe te reagueset që i pasojnë ato. Kjo analizë ndjek modelin ciklik të politikës (shiko Ushtrimin 7.9.).



## Ushtrimi 8.2. – Një qasje e strukturuar për zgjidhjen e konflikteve

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit mësojnë teknikën e zgjidhjes së konflikteve. Ata kuptojnë se zgjidhja e konflikteve varet në një shkallë të caktuar nga aftësi që mund të mësohen.
<b>Burimet</b>	Fletë pune për nxënësit: «Zgjidhja e konflikteve në gjashtë faza». Gazeta dhe revista.

### Procedura

1. Mësuesi përshkruan situatën e një konflikti për të cilin nuk ka zgjidhje të përcaktuar (shembull: një nxënës tallet me një nxënës tjetër që vjen nga një vend i huaj dhe flet me theks të fortë).  
Situata mund të paraqitet nëpërmjet një demonstrimi. Nxënësit diskutojnë si mund të zgjidhet konflikti. Në këtë mënyrë, ata mund të parashikojnë pjesë të modelit që do të përdorin në këtë mësim ose të bëjnë pyetje që modeli mund t'u përgjigjet.
2. Fleta e punës ku është shkruar «Zgjidhja e konfliktit në gjashtë faza» u shpërndahet gjysmës së nxënësve, të cilët e studiojnë në heshtje.  
Gjysma tjetër e klasës zgjedh raportimin e një konflikti nga një gazetë ose revistë. Ata mund të përdorin përvojën vetjake ose njohuritë e fituara vetë.
3. Nxënësit formojnë grupe me katër veta që përbëhen nga dy nxënës që e kanë lexuar zgjidhjen e problemeve dhe dy të tjerët që i kanë përcaktuar konfliktet e mundshme.
4. Nxënësit zgjedhin një konflikt dhe provojnë idetë e zgjidhjes së konflikteve.  
Dy janë kundërshtarë, ndërsa dy të tjerët veprojnë si ndërmjetës, duke përdorur fletët për të gjetur një zgjidhje.
5. Seancë plenare:
  - Çfarë konflikti jeni përpjekur të zgjidhni?
  - Si u përpoqët ta zgjidhnit atë?
  - (Si) ju ka ndihmuar modeli i zgjidhjes së konflikteve?

### Variacion

1. Nxënësit përqendrohen në një studim rasti dhe krahasojnë zgjidhjet e tyre.
2. Sapo nxënësit njihen me procedurën, ajo mund të zbatohet për konfliktet që ndodhin, aktualisht, në klasë.

### Materialet

*(shih faqen në vijim)*

## Fletë pune për nxënësit: zgjidhja e konflikteve në gjashtë faza

<p>1. Identifikoni nevojat. «Çfarë ju nevojitet (çfarë dëshironi saktësisht?)»</p>	<p>Çdo person që është i përfshirë në konflikt duhet t'i përgjigjet kësaj pyetje, pa akuzuar ose fajësuar tjetrin.</p>
<p>2. Përcaktoni problemin. «Çfarë besoni se është problemi në këtë rast?»</p>	<p>Tërë klasa mund të ndihmojë për të gjetur përgjigjen që plotëson nevojat e të interesuarve. Kundërshtarët duhet të jenë në gjendje ta pranojnë shpjegimin.</p>
<p>3. Kërkoni një numër zgjidhjesh. «Kush mund të mendojë për mënyrën e zgjidhjes së mundshme të problemit?»</p>	<p>Të gjithë anëtarët e klasës mund të kontribuojnë me përgjigje. Këto duhet të shkruhen, pa asnjë koment, gjykim ose vlerësim. Në këtë fazë, pikësynimi është që të prodhohen sa më shumë zgjidhje të jetë e mundur.</p>
<p>4. Vlerësoni zgjidhjet. «A do të kënaqeshit me këtë zgjidhje?»</p>	<p>Secila palë që është e përfshirë në konflikt rishikon alternativat, duke shpjeguar se cilat janë të pranueshme, apo jo.</p>
<p>5. Vendosni cila zgjidhje është më e mirë. «A e pranoi të dy këtë zgjidhje? A është zgjidhur problemi?»</p>	<p>Duhet të jetë e qartë që të dyja palët e pranojnë zgjidhjen. Duhet vlerësuar përpjekjet e tyre për të gjetur zgjidhje.</p>
<p>6. Shikoni si zbatohet zgjidhja. «Le të flasim edhe një herë për këtë situatë dhe të sigurohemi se problemi është zgjidhur me të vërtetë.»</p>	<p>Duhet bërë një plan për të vlerësuar zgjidhjen. Vlerësimi, në varësi të natyrës së konflikteve dhe moshës së kundërshtarëve, mund të kryhet minuta, orë ose një ditë më vonë.</p>

## Ushtrimi 8.3. – Konfliktet në familje dhe me bashkëmoshatarët

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit mësojnë rreth zgjidhjes së konflikteve në mënyrë të strukturuar.
<b>Burimet</b>	Komplet shënimesh të shtypura për nxënësit: «Zgjidhja e konflikteve në gjashtë faza» (shiko Ushtrimin 8.2).

### Procedura

1. Nxënësit lexojnë fletën e punës «Zgjidhja e konflikteve në gjashtë faza».
2. Mësuesi lejon të paraqitin shembuj të konfliktesh tipike në shtëpi, shkollë ose në sheshin e lojërave; për shembull:  
Në shtëpi:
  - Fëmija dëshiron të luajë, por prindërit mendojnë se ai ose ajo duhet të studiojë.
  - Fëmija kërkon të holla për të vajtur kinema/koncert/vizitë/piknik, por prindërit kanë shpenzime të tjera më të rëndësishme.Në sheshin e lojërave:
  - Djemtë dhe vajzat duan të përdorin sheshin e lojërave për qëllime të ndryshme.
  - Djemtë, ndërkohë, shqetësojnë vajzat që luajnë.
3. Nxënësit zgjedhin të punojnë për një konflikt dhe formojnë grupe me nga katër deri në gjashtë veta.
4. Pastaj, çdo grup ndahet në dy pjesë, gjysma e grupit merr rolin e prindërve, kurse gjysma tjetër merr rolin e fëmijëve (të djemve ose të vajzave).  
Së pari, grupi i parë mblidhet veç nga grupi i dytë për të ushtruar me rolin. Më pas, ata takohen me kundërshtarët për t'u marrë vesh për një zgjidhje, duke ndjekur gjashtë fazat.  
Pas një kohe të caktuar diskutimi ndalon dhe grupet kthehen në klasë.
5. Tërë klasa informon për punën e kryer në grupe. Çfarë zgjidhjesh kanë arritur? A u propozuan shumë zgjidhje të ndryshme?

### Variacion

Ky ushtrim mund të bëhet edhe me një ndërmjetës, për shembull, me një nxënës që merr rolin e gjyshit a të gjyshes dhe që drejton palë në konflikt drejt një marrëveshjeje.

## Ushtrimi 8.4. – Ide për konfliktin dhe paqen

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit mund të përcaktojnë konceptet e mosmarrëveshjeve dhe të paqes. Nxënësit mund të shpjegojnë se cilat mosmarrëveshje mund të zgjidhen dhe cilat jo.
<b>Burimet</b>	Letra me figura shpjeguese dhe shënjes me ngjyra.

### Procedura

1. Te një nga fletët shkruhet fjala «KONFLIKT».  
Nxënësve u jepen dy detyra për nxitjen e mendimit.
  - a. Ata hedhin me shkrim sa shumë shprehje ose fjalë që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet që vijnë në mendje.
  - b. Ata shtojnë fjalët kyçe që kanë lidhje me situatat e mosmarrëveshjeve.  
Kjo pjesë kryhet në heshtje, pa bërë komente.
2. Kur nxënësve u shterojnë idetë, në fletën tjetër shkruhet fjala «PAQE».  
Ndiqet e njëjta procedurë.
3. Klasa diskuton përfundimet.
4. Nxënësit, në bashkëpunim me mësuesin klasifikojnë konfliktet në disa tipa:
  - Konflikte që *mund* të zgjidhen
  - Konflikte që *nuk mund* të zgjidhen.

Zgjidhja e konflikteve pa humbës (shih Ushtrimin 8.1.) shpesh herë është e mundur vetëm nëpërmjet kompromisit. Kjo vepron kur, për shembull, burimet e pakta duhet të ndahen në mënyrë të drejtë. Nëse torta është e vogël dhe çdo person merr nga një pjesë të vogël të barabartë, unë mund ta pranoj zgjidhjen edhe sikur të mbetem i uritur. Por, nëse ndodh ndonjë përplasje vlerash dhe bindjesh fetare, atëherë kompromisi vështirë se është i mundshëm. E nëse një konflikt shkaktohet nga ndarjet etnike ose racore, ekziston rreziku i dëbimit ose i shfarosjes fizike të anëtarëve të një asaj pjese të popullsisë. Sa më e mençur të jetë qasja ndaj konflikteve, aq më e madhe është edhe mundësia për ta zgjidhur atë me marrëveshje, kompromis dhe pa dhunë. Zgjidhja me mend e konflikteve kërkon që palët të bëjnë dallimin mes çështjes dhe kundërshtarit dhe të respektojnë dinjitetin e kundërshtarit njerëzor në lidhje me të drejtat e njeriut.

### Zgjerim

Nxënësit ilustrojnë situata të ndryshme të paqes dhe konflikteve nëpërmjet vizatimeve ose artikujve e fotove nga shtypi.

## Ushtrimi 8.5. – Shtatoret

<b>Objektivi mësimor</b>	Nxënësit janë në gjendje të identifikojnë situatat e shtypjes, të zhvillojnë aftësinë krijuese në zgjidhjen jo të dhunshme të mosmarrëveshjeve dhe të përdorin gjuhën e trupit si mjet shprehës.
<b>Burimet</b>	Asnjë.

### Procedura

1. Nxënësit kryejnë ushtrimet paraprake të mëposhtme në çifte:
  - Një nxënës mban një qëndrim; një tjetër e imiton. Ata ndryshojnë rolet.
  - Një nxënës e vë dorën disa centimetra larg nga ajo e bashkëpunëtorit të tij. Kur ai/ajo lëviz dorën e tij/saj tjetra rrotullohet në çfarëdo pozicioni (të pakëndshëm) që lipset për të ruajtur të njëjtën largësi.Këto ushtrime i stërvitin nxënësit ta kenë mendjen te njëri-tjetri.
2. Në seancën plenare, nxënësit paraqitin dhe diskutojnë raste shtypjeje:
  - Dy ose më shumë nxënës pranojnë një ide dhe pastaj formojnë një grup me shtatore për të paraqitur një situatë shtypjeje (shembull: një fëmijë që rri në gjunjë i lustron këpucët një të pasuri që rri ulur).
  - Nëse një anëtar nga të pranishmit mendon ndonjë mënyrë për të zgjidhur gjendjen dhe e bën më të barabartë, atëherë ai/ajo aktorët i vendos ndryshe sipas modelit të ri të tij.Do të qe mirë që ky ushtrim të kryhet në heshtje, për t'i nxitur nxënësit për të kumtuar me mimikë dhe për të zhvilluar shprehësinë.
3. Pak nga pak, aktorë të tjerë mund të marrin pjesë në skenë.
4. 10 deri 15 minutat e fundit të mësimit mësuesi i lë për ndjekjen e një seance plenare. Nxënësit japin reagimet, dhe mund të paraqitin pyetje që mund të çojnë në studim të mëtejshëm.

### Variacion

1. E njëjta procedurë përdoret për të ilustruar të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve dhe rastet sesi janë shkelur.
2. Ushtrimi mund të ribëhet në situata mosmarrëveshjesh dhe në situata të vërteta që ngjallin ndjenja të forta.

## Ushtrimi 8.6. – Ndëshkimi kundrejt zgjidhjeve pozitive të konflikteve

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit nxiten të pranojnë nocionin e ligjit dhe të rregullave në grup. Nxënësit janë në gjendje të pranojnë dallimet dhe të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse. Ata zhvillojnë potencialin e tyre krijues në zgjidhjen e konflikteve.
<b>Burimet</b>	Fleta e punës për nxënësin: «Lista e ndëshkimeve».

### Procedura

1. Nxënësit shprehin ide për format e ndëshkimit. Kjo hyrje e mësimi i trajton si ekspertë, meqë ata mund të shfrytëzojnë përvojën dhe vëzhgimin. Tanimë, ata mund të vijojnë me komente.  
Mësuesi u shpërndan nxënësve fletën e punës me titull «Lista e ndëshkimeve», të cilën ata e lexojnë në heshtje.
2. Nxënësit diskutojnë në grupe të vogla (me tre ose katër vetë) se cilat ndëshkime kanë kuptim e cilat jo.
3. Grupet ndajnë rezultatet e tyre me grupet e tjera (këtu është e dobishme loja formuese shiko Ushtrimin 5.3).
4. Nxënësit kthehen në grupet e tyre për të diskutuar se cili ndëshkim, nëse ka ndonjë, duhet zbatuar në situatat e mëposhtme:
  - Një nxënës arrin me vonesë në shkollë.
  - Nxënësi nuk i ka bërë detyrat e shtëpisë.
  - Një nxënës pengon punën në klasë.
  - Një nxënës fyen një shok klase për shkak të prejardhjes të tij/saj etnike ose të besimit fetar.
  - Një nxënës ngacmon një nxënëse.
  - Një nxënës është i dhunshëm në klasë/gjatë pushimit.
5. Seancë plenare: nxënësit paraqitin rezultatet e tyre.  
Diskutimi në vazhdim do t'i japë përgjigje kësaj pyetjeje: a ka alternativa të tjera përveç detyrimit të ndëshkimit (p.sh., ndërmjetësimi mes keqbërësit dhe viktimës)?

### Zgjerim

Nxënësit çojnë deri në fund skenën e zgjidhjes pozitive, krijuese të konflikteve në klasë.

### Materialet

(shih faqen në vijim)

## **Fleta e punës e nxënësit**

### **Lista e ndëshkimeve**

1. Shkrimi i një poezie
2. T'u tregosh një përrallë fëmijëve të vegjël
3. Të tregosh shaka dhe gjëza në klasë.
4. Dhjetë ulje-ngritje për sharjet
5. Qëndrimi në klasë pas mësimit për aq minuta sa u vonua në mëngjes
6. Të rrijë në këmbë teksa shkruan
7. Përgatitja e mësimit për klasën
8. Të merret një orë me kopshtari
9. Pastrimi i hapësirës çlodhëse
10. Pastrimi i klasës
11. Largimi nga mësimi
12. T'i vrapojë dhjetë herë rreth ndërtesës së shkollës
13. Ndalim i lëvizjes gjatë pushimit
14. Punë shtesë në një nga lëndët ku nxënësi është i dobët
15. Pagesa e një gjobe që ndihmon për të mbuluar shpenzimet e përgjithshme
16. Të shkruajë një shfajësim
17. Sugjerime të mëtejshme...

## Ushtrimi 8.7. – Pakicat

<b>Objektivi mësimore</b>	Nxënësit kuptojnë se ndjenja e përjashtimit mund të jetë pasojë jo vetëm e mënyrës si anëtarët e tjerë të shoqërisë të shikojnë, por edhe e mënyrës si të shohin anëtarët e grupit ku bën pjesë.
<b>Burimet</b>	Një grup skedash pozitive dhe një grup skedash negative për secilin grup. Dy fleta pune me figura ilustruese për çdo grup, njëra përmban fjalën «Ndjenjat», ndërsa tjetra fjalën «Veprimet». Stilolapsa me ngjyra.

### Procedura

Në fillim të lojës, është e rëndësishme që nxënësit të mos kenë asnjë ide të asaj që përfaqësojnë, përndryshe sakaq mund t'u drejtohen ideve të menduara që më parë të cilat do të shtrembëronin drejtimin e lojës.

Loja përbën një shembull të përfshirjes së kujdesshme e të ndërlikuar nga ana e mësuesit. Nxënësit, brenda kornizës së rreptë, kanë liri të madhe për të zhvilluar e shprehur idetë dhe përvojat e tyre.

1. Nxënësit formojnë grupe me nga katër deri në gjashtë veta (parapëlqehet jo më shumë).
2. Secili grup merr një tufë skedash pozitive, një stilolaps shënjuar dhe dy fleta letre me figura ilustruese. Mësuesi u kërkon nxënësve të caktojnë një sekretar, në mënyrë që të dokumentojë komentet e grupit dhe reagimet te letrat me figura ilustruese. Me radhë, të gjithë anëtarët e grupit regjistrojnë reagimet e tyre.
3. Mësimdhënësi u tregon nxënësve se ata, në këtë ushtrim, nuk do të përfaqësojnë veten e tyre, por do të veprojnë si anëtarë të një pakice. Hëpërhë, ata jo vetëm që duhet të hetojnë se kush janë, por edhe të marrin parasysh mesazhet në skeda që përshkruajnë ata dhe gjendjen e tyre.
4. Nxënësit lexojnë me zë, njëri pas tjetrit, skedat anëtarëve të tjerë të grupit. Mbasi t'i kenë lexuar të gjashta skedat, atëherë te fleta ku ndodhet rubrika «NDJENJAT» ata shkruajnë përgjigjet e tyre për pyetjen: «Si ndihesh si anëtar i këtij grupi?».
5. Mësuesi i shpërndan secilit grup, gjashtë skedat negative, e ato përsëritin Hapin 4.
6. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që t'i përgjigjen kësaj pyetjeje: «Çfarë do të bënit sikur të ishit në një situatë të ngjashme?» Përgjigjet duhet të shkruhen në fletën, me titull «VEPRIMET». Nxënësit duhet të mbajnë në mend se ata ende ndodhen në të njëjtin grup që shprehu ndjenjat në fletën e parë. Ndoshta diçka që kanë ndier a shkruar në atë fletë mund t'i ndihmojë të vendosin si të veprojnë.
7. Seanca plenare:
  - Secili grup i paraqet pjesës tjetër të klasës ndjenjat e parashtruara në fletën e titulluar «NDJENJAT».
  - Kur të gjitha grupet të përfundojnë Pjesën I, mësuesi u kërkon të paraqitin sugjerimet e tyre te fleta ku gjendet rubrika «VEPRIMET». Klasa duhet të identifikojë veprimet konstruktive, veprat e dhunës dhe dallimet midis nxënësve si brenda, edhe jashtë grupeve.
8. Mësuesi i pyet nxënësit se si kanë punuar në grup dhe nëse hasën ndonjë problem ndërkohë që bënë ushtrimin (bashkëpunimi, udhëheqja etj.), e se çfarë mendojnë që kanë mësuar nga ushtrimi: për veten, për reagimet e tyre dhe për grupin. A mundën ata të vendosin një marrëdhënie mes pakicës që përfaqësojnë dhe grupeve të tjera që mund të njohin?
9. Së fundi, mësuesi u tregon nxënësve se grupi, i përfaqësuar nga ata, është grupi i endacakëve ose, siç njihet ndryshe, Romët ose Ciganët.



## Zgjerim

Nxënësit krahasojnë idetë e tyre me *Marrëveshjen për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racia*.<sup>8</sup> Studentët mund, po ashtu, të zbulojnë nëse situata e përshkruar përkon me atë në vendin e tyre, çfarë masash janë marrë nga autoritetet për t'u marrë me këtë problem dhe çfarë masash kanë këshilluar për zbatimin e marrëveshjes së lartpërmendur.

## Materialet

### Komplet skedash pozitive dhe negative

Shtëpitë tona janë ndryshe nga ato të njerëzve të tjerë. Ato janë të veçanta dhe ne i kemi mjaft për zemër ato. Na pëlqen të mbajmë traditat tona.	Shtypi dhe programet televizive nuk tregojnë të vërtetën për ne. Ata thonë se ne jemi problem. Nuk na lejojnë të themi pjesën tonë.
Ne kemi shumë aftësi. Bëjmë të gjitha llojet e punëve të krahut dhe ato të zejtarisë. Puna jonë është një ndihmesë e madhe për vendin ku jetojmë.	Disa njerëz na trajtojnë keq dhe na vënë damka. Ndonjëherë na sulmojnë pa arsye. Jo shumë kohë më parë, mijëra nga njerëzit tanë janë vrarë jashtë vendit.
Në të kaluarën, njerëzit tanë kanë kryer shumë bëma të guximshme. Ne na pëlqen të përkujtojmë historinë tonë.	Ne kurrë nuk kemi ujë të rrjedhshëm, mbeturinat tona mblidhen rrallë.
Ne jemi shumë të pavarur, madje parapëlqejmë të merremi me veten. Prandaj, nuk i detyrohem gjë kujt.	Disa mjekë nuk duan të merren me ne kur sëmuremi. Për ne është e vështirë të marrim përfitimet nga sigurimet shoqërore.
Ne na pëlqen të mblidhemi së bashku, të tregojmë histori si dhe të këndojmë këngë. Besojmë se kjo ka rëndësi të madhe për ta shijuar jetën.	Banorët nuk na duan në lagje. Disa njerëz nuk duan të na japin punë për shkak të asaj që jemi.
Përpiqemi të jetojmë pranë familjeve dhe miqve tanë. Për të moshuarit që bëjnë pjesë në bashkësinë tonë kujdesemi si s'ka më mirë. Ne i adhurojmë fëmijët tanë.	Ndonjëherë kemi probleme me policinë dhe pushtetin bashkiak për shkak të vendit që rastisim të zëmë.

---

<sup>8</sup> Kjo marrëveshje u pranua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 20 Nëntor 1963. Teksti është i arritshëm nëpërmjet internetit.

## Ushtrimi 8.8. – Pamje të luftës dhe të paqes

<b>Objektivat mësimore</b>	Nxënësit përcaktojnë aspekte të luftës dhe të paqes. Nxënësit zhvillojnë aftësinë e leximit të imazheve. Nxënësit janë në gjendje të shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre për luftën e paqen.
<b>Burimet</b>	Një grumbull me piktura (duke përfshirë fotografi, karikatura, reklama etj.).

### Procedura

1. Nxënësve u tregohen disa fotografi. E mira e të mirave do të ishte që ato të vareshin në muret rreth klasës ose në një korridor të ndriçuar mirë. Nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i shohin pikturat si në një ekspozitë.
2. Nxënësve u jepet mundësia për të komentuar në mënyrë të vetvetishme. Cilat pamje paraqitin paqen ose luftën? Mësuesi nuk i shtyn nxënësit të komentojnë. Në fund të kësaj faze hyrëse, ai bën të ditur nëse nxënësit kanë arritur të jenë të një mendjeje me komentet e tyre apo jo. Dallimet në perceptim nuk diskutohen më tutje.
3. Nxënësit zgjedhin një fotografi që i tërheq në veçanti. Ata duhet të mund ta shikojnë nga afër atë nëse duan. Pyetjeve të mëposhtme u përgjigjen me shkrim, në heshtje:
  - Çfarë shikoni (përshkrimi)?
  - Cilat janë mendimet tuaja (reflektimi dhe përfytyrimi)?
  - Cilat janë ndjenjat tuaja (emocionet)?
4. Grupe prej katër nxënësish zgjedhin pamjet dhe formojnë çifte me ide kundërshtuese. Ato mund të përfshijnë disa nga fotot që kanë studiuar në hapin 3, por mund të zgjedhin edhe foto të tjera.
5. Nxënësit paraqitin zgjedhjet në seancën plenare dhe japin arsyet për zgjedhjen e tyre. Nëse koha nuk është e kufizuar, atëherë secili grup duhet të paraqitë të paktën një çift kundërshtish.
6. Reflektim. Nxënësit shprehin ndjenjat dhe mendimet e tyre. Ata mund të ngrenë pyetje për situatat në fotografi, të cilat mund të çojnë në studime të mëtejshme.

### Zgjerim

E njëjta çështje mund të studiohet në letërsi dhe pikturë.  
Klasa organizon një ekspozitë për këto tema.

# Ilustrimet

## Hyrje


Ilustrimet e këtij libri janë bërë nga piktori zviceran Peti Wiskemann. Ato shprehin, me mjete artistike, temat kryesore të ushtrimeve, duke çelur kështu qasje të reja për të kuptuar qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut. Faqet në vazhdim përmbajnë riprodhime të pikturave me përmasa të plota, në mënyrë që të kopjohen dhe të paraqiten në klasë.

## Krijimi i atmosferës në klasë




Ilustrim nga Kapitulli 1  
Edukimi për demokracinë dhe të drejtat e njeriut – Vëllimi VI  
Mësimdhënia e demokracisë  
*Një përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetarinë demokratike dhe  
edukimin për të drejtat e njeriut*

## Qartësimi i vlerave



Ilustrim nga Kapitulli 2  
Demokracia dhe të Drejtat e Njeriut – Vëllimi VI  
Mësimdhënia e demokracisë  
*Një përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetarinë demokratike dhe  
edukimin për të drejtat e njeriut*

## Njohja me të drejtat e njeriut



Ilustrim nga Kapitulli 3  
Demokracia dhe të Drejtat e Njeriut – Vëllimi VI  
Mësimdhënia e demokracisë  
*Një përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetarinë demokratike dhe  
edukimin për të drejtat e njeriut*


## Të kuptojmë të tjerët



Ilustrim nga Kapitulli 4  
Demokracia dhe të Drejtat e Njeriut – Vëllimi VI  
Mësimdhënia e demokracisë

*Një përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetarinë demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut*

## Zbatimi i drejtësisë




Ilustrim nga Kapitulli 5  
Demokracia dhe të Drejtat e Njeriut – Vëllimi VI  
Mësimdhënia e demokracisë

*Një përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetarinë demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut*



## Të kuptojmë filozofinë politike



Ilustrim nga Kapitulli 6  
Demokracia dhe të Drejtat e Njeriut – Vëllimi VI  
Mësimdhënia e demokracisë

*Një përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetarinë demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut*

## Pjesëmarrja në politikë



Ilustrim nga Kapitulli 7  
Demokracia dhe të Drejtat e Njeriut – Vëllimi VI  
Mësimdhënia e demokracisë  
*Një përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetarinë demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut*

## Menaxhimi i konfliktit



Ilustrim nga Kapitulli 8  
Demokracia dhe të Drejtat e Njeriut – Vëllimi VI  
Mësimdhënia e demokracisë

*Një përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetarinë demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut*

Ky manual për mësuesin përmban një përmbledhje ushtrimesh dhe modelesh për Edukimin për Qytetarinë Demokratike (EQD) dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut (EDNJ) në shkolla dhe në mjediset jo-formale të arsimit. Këto modele mësimdhënieje sigurojnë kuadrin për të nxitur nxënësit të bëhen aktivë, përmes shembujve dhe thellimeve në të kuptuarit e e parimeve të përgjithshme të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut. Shumë ushtrime përshtaten me lehtësi për grup-mosha të ndryshme, ndërkohë që shkalla e reflektimit mund të jetë e ndryshme.

Larmia e gjerë e qasjeve pasqyron faktin që, për këtë libër, kanë kontribuar autorë nga të gjitha vendet e Evropës. Ata janë mbështetur në burime dhe tradita të ndryshme mësimdhënieje dhe të mësuarit dhe kanë përzgjedhur modele të njohura nga përvoja praktike dhe të testuar në klasë. Megjithatë, çdo pjesë të këtij libri përshkohet nga një kuptim i përbashkët për EQD/EDNJ: në EQD/EDNJ, metoda mbart mesazhin. Ky manual u jep lexuesve mundësinë të zgjedhin dhe provojnë traditat dhe qasjet e ndryshme në Edukimin për Qytetarinë Demokratike dhe në atë për të Drejtat e Njeriut.

Ky është Vëllimi VI nga një seri prej gjashtë librash:

<b>EQD/EDNJ Vëllimi I</b>	<i>Edukimi për demokraci</i> - Materiale në ndihmë të mësuesve të edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut
<b>EQD/EDNJ Vëllimi II</b>	<i>Rritemi në demokraci</i> - Njësi mësimore për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut në arsimin fillor
<b>EQD/EDNJ Vëllimi III</b>	<i>Të jetojmë në demokraci</i> - Veprimtari mësimore për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut për arsimin e mesëm të ulët
<b>EQD/EDNJ Vëllimi IV</b>	<i>Të marrim pjesë në demokraci</i> - Njësi mësimore për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut në ciklin e mesëm të lartë
<b>EQD/EDNJ Vëllimi V</b>	<i>Të eksplorojmë të drejtat e njeriut</i> – Nëntë projekte të shkurtëra për arsimin fillor
<b>EQD/EDNJ Vëllimi VI</b>	<i>Mësimdhënia e demokracisë</i> – Një përmbledhje modelesh për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut.



<http://book.coe.int>  
Botim i Këshillit të Evropës  
**[www.coe.int](http://www.coe.int)**

Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare, duke mbuluar pothuajse të gjithë kontinentin e Evropës. Ai kërkon të zhvillojë parimet e përbashkëta demokratike dhe ligjore, në bazë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Dokumenteve të tjera referencë, për mbrojtjen e individëve. Që kur ai u themelua, në vitin 1949, si pasojë e Dytë Luftës së Dytë Botërore, Këshilli i Evropës ka simbolizuar gjithnjë pajtimin.